

# Fazat e rikuperimit dhe riintegrimit të viktimave të trafikimit

## Udhëzues riintegrimi për profesionistët



---

*Ky Udhëzues Riintegrimi u përgatit nga Instituti NEXUS dhe “Të Ndryshëm & Të Barabartë” (D&E), në kuadër të projektit: Ofrimi i shërbimeve riintegruese gjithëpërfshirëse dhe përmirësimi i kuadrit të mbrojtjes për viktimat e trafikimit në Shqipëri. Ai është pjesë e një serie udhëzuesish riintegrimi të hartuar për të mbështetur punën e profesionistëve të riintegrimin në Shqipëri, si dhe të profesionistëve nga vendet dhe rajonet e tjera.*

---

Autore: Rebecca Surtees  
Kontribues: Mariana Meshi, Stela Tanellari, Ana Lila dhe Ornela Hinaj  
Faqosja dhe dizajni: Laura S. Johnson  
Ilustrim: Viktimat e trafikimit të asistuar nga “Të Ndryshëm & Të Barabartë”.

Citimi i sugjeruar: Surtees, R., M. Meshi, S. Tanellari, A.Lila dhe O. Hinaj, (2022), *Fazat e rikuperimit dhe riintegrimin të viktimave të trafikimit. Udhëzues riintegrimi për profesionistët*. Tiranë: “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, dhe Washington, D.C: Instituti NEXUS.

© 2022 Të Ndryshëm & Të Barabartë (D&E) dhe Instituti NEXUS

*Të Ndryshëm & Të Barabartë (D&E) është një organizatë jofitimprurëse e përkushtuar për të dhënë shërbime cilësore për mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit, shfrytëzimit dhe abuzimit, dhe për të ndryshuar kontekstin ligjor, institucional dhe social për të luftuar këto abuzime. Aktivitetet kryesore të D&E përfshijnë: identifikimin dhe referimin e viktimave; ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse, afatgjata të riintegrimin (rezidenciale dhe komunitare); ndërgjegjësimin e komuniteteve për trafikimin e personave dhe për të drejtat e viktimave të trafikimit; parandalimin e trafikimit nëpërmjet mbështetjes së grupeve të cënueshme; trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të partnerëve shtetërorë dhe të shoqërisë civile; studime dhe vlerësime; asistencë teknike në hartimin e ligjeve dhe legjislacionit për mbrojtjen e viktimave të trafikimit; dhe advokimin për të drejtat dhe mbrojtjen për viktimat e trafikimit.*



DIFFERENT & EQUAL  
TË NDRYSHËM & TË BARABARTË [www.differentandequal.org](http://www.differentandequal.org)



@DifferentEqual

*Instituti NEXUS® është një qendër e pavarur ndërkombëtare për kërkime dhe politika mbi të drejtat e njeriut. NEXUS i dedikohet dhënies fund të formave bashkëkohore të skllavërisë dhe trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe abuzimeve dhe veprave të tjera penale që ndërthurin të drejtat e njeriut dhe politikat e të drejtën penale ndërkombëtare. NEXUS është lider në kërkime, analiza, vlerësime dhe asistencë teknike, dhe në zhvillimin e qasjeve novatore për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe problematika lidhur me të.*



NEXUS  
Institute [www.NEXUSInstitute.net](http://www.NEXUSInstitute.net)



@NEXUSInstitute



## **Mbështetja**

Ndonjëherë, e vetmja gjë që dëshironi është të  
keni dikë që t'ju gjendet pranë...

*Ilustrim dhe citim nga viktima  
të trafikimit të asistuar nga  
D&E*

## Tabela e përmbajtjes

<b>Rreth udhëzuesit të riintegritimit.....</b>	<b>1</b>
Çfarë është ky udhëzues .....	1
Audiencia e synuar e këtij udhëzuesi.....	1
Si ta përdorim këtë udhëzues .....	2
<b>Të kuptuarit e procesit të riintegritimit të viktimave të trafikimit .....</b>	<b>3</b>
Korniza e riintegritimit.....	3
Tre fazat e riintegritimit.....	9
Pengesat dhe sfidat e riintegritimit.....	11
<b>Faza 1. Ndërrhyrja gjatë krizës (nga 0 në 6 muaj).....</b>	<b>154</b>
Rreth fazës së krizës.....	154
Ndjenjat dhe sjelljet e viktimës në fazën e krizës.....	16
Asistenca dhe mbështetja e nevojshme në fazën e krizës.....	17
<i>Çështje specifike dhe konsiderata në mbështetje të fëmijëve të trafikuar në fazën e krizës.....</i>	<i>20</i>
Çështje të rëndësishme dhe konsiderata në fazën e krizës.....	22
<b>Udhëzime për profesionistët.....</b>	<b>22</b>
<b>Faza 2. Faza e tranzicionit (nga 7 në 12 muaj) .....</b>	<b>24</b>
Rreth fazës së tranzicionit .....	24
Asistenca dhe mbështetja në fazën e tranzicionit .....	26
<i>Çështje specifike dhe konsiderata në mbështetje të fëmijëve të trafikuar në fazën e tranzicionit...31</i>	
Çështje të rëndësishme dhe konsiderata në fazën e tranzicionit.....	32
<b>Udhëzime për profesionistët.....</b>	<b>32</b>
<b>Faza 3. Riintegrimi dhe përfshirja (nga 13 në 36 muaj).....</b>	<b>34</b>
Rreth fazës së riintegritimit dhe përfshirjes .....	34
Ndjenjat dhe sjelljet e viktimës në fazën e riintegritimit dhe përfshirjes .....	35
Asistenca dhe mbështetja në fazën e riintegritimit dhe përfshirjes.....	36
<i>Çështje specifike dhe konsiderata në mbështetje të fëmijëve të trafikuar në fazën e riintegritimit dhe përfshirjes.....</i>	<i>39</i>
Çështje të rëndësishme dhe konsiderata në fazën e riintegritimit dhe përfshirjes.....	41
<b>Udhëzime për profesionistët.....</b>	<b>41</b>
<b>Shtojcat .....</b>	<b>43</b>
<b>Shtojca #1. Fjalorthi i termave.....</b>	<b>44</b>
<b>Shtojca #2. Arritjet kryesore në faza të ndryshme të riintegritimit .....</b>	<b>46</b>
<b>Shtojca #3. Ndjenjat dhe sjelljet e viktimave në faza të ndryshme të riintegritimit .....</b>	<b>47</b>
<b>Shtojca #4: Parimet etike dhe udhëzimet në punën me viktimat e trafikimit .....</b>	<b>48</b>
<b>Shtojca #5: Studime dhe burime mbi riintegrimin nga D&amp;E dhe Instituti NEXUS .....</b>	<b>49</b>

## Rreth udhëzuesit të riintegrit

### Çfarë është ky udhëzues

Riintegrimi është një proces rikuperimi dhe përfshirjeje pas një eksperience trafikimi. Zakonisht përfshin tre faza për një periudhë afersisht tre vjeçare-1) faza e krizës, 2) faza e tranzicionit dhe 3) faza e riintegrit dhe përfshirjes.

Udhëzuesi i riintegrit u ofron profesionisteve informacion rreth tre fazave, përvojat dhe nevojat e viktimave gjatë këtyre fazave si dhe si të mbështetet riintegrimi i viktimave me kalimin e kohës.



Ky udhëzues riintegriti përshkruan tre fazat e riintegrit në të cilat viktimat e trafikimit kalojnë duke përfshirë një përshkrim të çdo faze specifike, ndjenjat dhe sjelljet në çdo fazë, mbështetjen dhe asistencën e nevojshme të dhënë. Secila pjesë përmbillet me një listë kontrolli me sugjerime për profesionistët e riintegrit që t'i zbatojnë në çdo fazë specifike të riintegrit.

Ky udhëzues riintegriti bazohen në përvojën e D&E dhe NEXUS në zbatimin e programeve të riintegrit për viktimat e trafikimit ndër vite, si dhe në kërkimet dhe njohuritë tona për këtë temë të rëndësishme. Po ashtu, këta udhëzues përfshijnë përvoja nga jeta reale dhe reflektime të viktimave të trafikimit, si dhe të profesionistëve që punojnë me ta.

### Audienca e synuar e këtij udhëzuesi



Ky udhëzues synon profesionistët që punojnë për rikuperimin dhe riintegritin e të rriturve dhe fëmijëve viktimat të trafikimit në Shqipëri, si dhe në fusha të tjera. Këtu përfshihen punonjës socialë dhe asistentë socialë, psikologë dhe këshillues, profesionistë të kujdesit shëndetësor, avokatë dhe paraligjorë, staf arsimor (mësues, drejtorë shkolle, psikologë shkolle), punonjës të mbrojtjes së fëmijëve, administratorë publikë dhe profesionistë që punojnë në fuqizimin ekonomik dhe punësimin.

## Si ta përdorim këtë udhëzues

Ky udhëzues riintegrimi për profesionistët është një burim praktik që profesionistët e riintegrit mund ta përdorin në punën e tyre të përditshme të riintegrit. Ai mund të përdoret për të përgatitur dhe trajnuar profesionistë, si dhe për referim gjatë punës së vazhdueshme të riintegrit.

Ai është pjesë e një serie udhëzuesish riintegrit që shqyrtojnë aspekte të ndryshme të rikuperimit dhe riintegrit, dhe që shpjegojnë dhe ofrojnë udhëzime se si mund të adresohen çështje dhe pengesa kyç në riintegritin e viktimave të trafikimit. Profesionistët e riintegrit duhet t'iu referohen udhëzuesve përkatës kur kryejnë punën e tyre me viktimat e trafikimit. Kjo seri përfshin tre udhëzues riintegrit për aspekte të ndryshme të rikuperimit dhe riintegrit, duke përfshirë:

- Fazat e rikuperimit dhe riintegrit të viktimave të trafikimit
- Mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit
- Mentorimi i viktimave të trafikimit


Kjo seri udhëzuesish riintegrit për profesionistët është hartuar nga “Të Ndryshëm & Të Barabartë” (D&E) dhe Instituti NEXUS.

# Të kuptuarit e procesit të riintegrit të viktimave të trafikimit<sup>1</sup>

## Korniza e riintegrit

Trafikimi ka ndikime shumë serioze në mirëqenien fizike, psikologjike, ekonomike dhe sociale të viktimave të trafikimit. Përveç kësaj, shumë viktima të trafikimit janë përballur me probleme në jetën e tyre përpara trafikimit, të cilat vazhdojnë edhe pas trafikimit. Probleme të tjera gjithashtu shfaqen përgjithësisht në jetën dhe marrëdhëniet e tyre gjatë periudhës së rikuperimit dhe riintegrit. Për shembull, shumë viktima kanë migruar për shkak të problemeve ekonomike në familje, dhe në përgjithësi situata e tyre ekonomike është përkeqësuar më shumë për shkak të trafikimit. Për rrjedhojë, riintegrit nuk ka të bëjë vetëm me adresimin e ndikimit që ka pasur trafikimi në jetën e viktimave, por edhe me adresimin e faktorëve vulnerabël të situatës para trafikimit, si dhe të sfidave që shfaqen në jetë pas përfundimit të periudhës së trafikimit dhe shfrytëzimit.

## *Cënueshmëria dhe aftësia ripërtëritëse përpara trafikimit, për shkak të trafikimit dhe pas trafikimit*



Riintegrit është proces i rikuperimit dhe përfshirjes ekonomike dhe sociale pas një përvoje trafikimi. Ai mund të kuptohet më mirë si një proces që personat e trafikuar e përshkojnë teksa rikuperohen dhe lënë pas shfrytëzimin, trafikim. Riintegrit i suksesshëm përfshin:



sistemimin në një mjedis të qëndrueshëm dhe të sigurt,

<sup>1</sup> Kjo pjesë bazohet në punën e kryer nga Instituti NEXUS dhe 15 OJF në Ballkan, duke përfshirë D&E, në kuadër të Programit të Riintegrit të Viktimave të Trafikimit (PRVT), të zbatuar gjatë viteve 2006-2015 dhe të financuar nga Fondacioni King Baudouin (KBF). Për më shumë informacion rreth PRVT-së, ju lutemi shihni: <https://nexusinstitute.net/past-projects/trafficking-victims-reintegration-programme-tvrrp/>  
Kjo pjesë bazohet edhe në punën e Institutit NEXUS në projekte të tjera, duke përfshirë: Nismën Rajonale për Riintegrit: Sfidat për Riintegritin në Nënrajonin e Mekongut të Madh, në bashkëpunim me UNIAP dhe qeveritë COMMIT në Nënrajonin e Mekongut të Madh për periudhën 2010-2017 (ju lutemi shihni: <https://nexusinstitute.net/past-projects/commit-ppc5-regional-reintegration-initiative/>) dhe Mbrojtjen e të Paasistuarve dhe të Nënshërbyerve: Studim afatgjatë i bazuar në evidenca mbi asistencën dhe riintegritin, i zhvilluar në partneritet me Qeverinë e Indonezisë dhe partnerë të shoqërisë civile në Indonezi, për periudhën 2013-2019 (ju lutemi shihni: <https://nexusinstitute.net/past-projects/reintegration-in-indonesia/>). Për burime dhe kërkime kyç, ju lutemi shihni: <https://nexusinstitute.net/publications/assistance-and-reintegration-of-trafficking-victims/>



aksesin në një standard të arsyeshëm jetese,



mirëqenien mendore dhe fizike,



mundësitë për zhvillim personal, social dhe ekonomik, dhe



aksesin në mbështetje sociale dhe emocionale.<sup>2</sup>

Riintegrimi mund të përfshijë kthimin në familjen dhe/ose komunitetin e vet të origjinës. Ai mund të përfshijë edhe integrimin në një komunitet të ri, ose madje në një shtet të ri.

Një aspekt kryesor i riintegritimit të suksesshëm është ai i fuqizimit, mbështetjes së viktimave për të zhvilluar aftësi për të qenë të pavarur dhe të vetëmjaftueshëm, dhe për t'u përfshirë në mënyrë aktive në rikuperimin dhe riintegrimin e tyre.

### *Komponentët e ndryshëm të riintegritimit të suksesshëm*




Trafikimi ndikon edhe në marrëdhëniet familjare të viktimës dhe shumë viktimë përballen me tensione dhe probleme në mjediset e tyre familjare, si dhe në mjedise më të gjera shoqërore. Për rrjedhojë, ka nivele të ndryshme ku mund të ndodhë riintegrimi, dhe se çfarë duhet marrë në konsideratë lidhur me mënyrën se si profesionistët punojnë dhe i mbështetin viktimat gjatë gjithë procesit të rikuperimit dhe riintegritimit. Riintegrimi nënkupton kapërcimin e këtyre problemeve dhe ndjeshmërive nëpërmjet këtyre niveleve - individual, familjar, komunitar dhe strukturor – dhe

<sup>2</sup> Ky përkufizim u zhvillua në bashkëpunim me Institutin NEXUS dhe 15 OJF partnere në kuadër të programit PRVT të KBF-së. Ju lutemi shihni: Surtees, R. (2008) *Ri/integrimi i personave të trafikuar: si mund të jetë puna jonë më efektive?* Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni King Baudouin, f. 11.



maksimizimin e burimeve të ripërteristjes dhe mbështetjen në jetën e viktimave dhe në mjedisin e gjerë.

### *Nivelet e riintegrit: individual, familjar, komunitar dhe strukturor<sup>3</sup>*



**Niveli individual.** Riintegrimi duhet të adresojë ndikimin e trafikimit (fizik, psikologjik, social dhe ekonomik) te vetë viktimat. Disa viktimat përballen edhe me probleme të ndërlikuara dhe të pazgjdhura, madje edhe me traumën përpara trafikimit. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e çdo viktime, si dhe kapacitetet, aftësitë dhe burimet për të ofruar asistencë të përshtatur dhe të personalizuar, dhe për të maksimizuar burimet e tyre personale të forcës dhe aftësisë ripërtëritëse.



**Niveli familjar.** Riintegrimi ndodh shpesh në mjedisin familjar të viktimës. Mjedisi familjar është shpesh një terren kompleks me shtresa të ndryshme mbështetjeje dhe tensionesh. Në procesin e riintegritit mund të përfshihet një numër i madh pjesëtarësh të familjes, në shkallë dhe faza të ndryshme të jetës pas trafikimit dhe mund të shfaqin veprime dhe reagime, qëndrime dhe sjellje të ndryshme (dhe shpesh kontradiktore), sidomos me kalimin e kohës dhe si përgjigje ndaj faktorëve të jashtëm. Disa pjesëtarë të familjes janë mbështetës dhe ndihmues; të tjerët mund të jenë kritikë dhe jombështetës. Të gjithë këta faktorë dhe ndryshime ndikojnë në mënyrë të diferencuar në rezultatet e riintegritit për viktimat dhe familjet e tyre të gjera; disa herë pozitivisht, dhe herë të tjera negativisht. Puna me familjen përfshin nxitjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe mbështetës për kthimin e viktimave, dhe për jetën e familjes në përgjithësi. Gjithashtu, ajo përfshin shpesh ofrimin e mbështetjes për pjesëtarë të ndryshëm të familjes, si për shembull mbështetje për rregjistrimin dhe ndjekjen e shkollës për fëmijët e viktimave të trafikimit ose mundësi punësimi për prindërit e viktimave të trafikimit.



**Niveli komunitar.** Mjedisi komunitar është një faktor i rëndësishëm në suksesin ose dështimin e riintegritit të viktimave. Komuniteti përfshin ata që janë pranë dhe që përfshihen ngushtësisht në jetën e një viktime të trafikimit, si dhe ata në sferën e gjerë (dhe më distante) shoqërore të viktimës (shokë, të afërm, fqinj, bashkëmoshatarë, kolegë pune, drejtues komuniteti). Mjedisi komunitar mund

<sup>3</sup>Surtees, R. (2017) *Të ecim përpara. Riintegrimi në familje dhe komunitet i viktimave të trafikimit në Indonezi*. Uashington DC: Instituti NEXUS; Surtees, R. (2017) *Jeta jonë. Cenueshmëria dhe aftësia ripërtëritëse te viktimat e trafikimit në Indonezi*. Uashington DC: Instituti NEXUS.

të jetë një mjedis kompleks dhe kontradiktor, i cili është mbështetës dhe jombështetës dhe përfshin reagime të ndryshme (madje kontradiktore) nga shokët, fqinjët dhe të tjerët, duke përfshirë ndryshime me kalimin e kohës. Në nivel komunitar, është e rëndësishme të vlerësohet dhe nxitet një mjedis i shëndetshëm nëpërmjet krijimit të rrjeteve shoqërore, sigurimit të disponueshmërisë dhe aksesit në shërbime dhe mundësi, dhe punës me pjesëtarët e komunitetit për të luftuar stigmën dhe diskriminimin.



**Niveli strukturor.** Riintegrimi në shoqërinë formale dhe institucionet e saj përfshin garantimin se viktimat e trafikimit kanë status juridik, i cili iu jep atyre të drejtën për shërbime dhe që këto shërbime të jenë të disponueshme dhe të aksesueshme, veçanërisht në nivel vendor ku këto viktima të trafikimit riintegrohen.

## Rezultatet e riintegritit të suksesshëm<sup>4</sup>



<sup>4</sup> Surtees, R. (2010) *Monitorimi i programeve të ri/integrimit kundër trafikimit. Manual*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni King Baudouin.

Për të arritur këto rezultate, viktimat e trafikimit kërkojnë mbështetje dhe shërbime të ndryshme për t'u rikuperuar dhe riintegruar pas trafikimit. Ata mund të kërkojnë një shërbim të vetëm (për shembull, transport, kujdes mjekësor për urgjenca, sistemim në punë) ose shërbime të shumëfishta (për shembull, një ndërthurje e strehimit, asistencës mjekësore, kujdesit psikologjik, mbështetjes ligjore, arsimit dhe formimit profesional). Shërbimet mund të jenë specifike për trafikimin (të ofruara nga organizata dhe institucione kundër trafikimit) ose mund të jenë më të përgjithshme (për shembull, të ofruara nga agjenci/institucione që punojnë me personat e cenueshëm, migrantët e kthyer, zhvillimin komunitar, mbrojtjen e fëmijëve). Një paketë gjithëpërfshirëse e asistencës për riintegrim përfshin format e mbështetjes, shërbimet të paraqitura më poshtë.

### *Asistenca dhe shërbimet për rikuperimin dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit<sup>5</sup>*



**Strehim, akomodim dhe alternativa të kujdesit.** Ofrimi i akomodimit të sigurt, të kënaqshëm dhe të përballueshëm dhe i alternativave të kujdesit (për shembull, në një strehëz, duke jetuar me familjen, në apartament me qira, familje kujdestare, sistemim alternativ).



**Asistencë mjekësore.** Asistencë dhe kujdes mjekësor i përshtatshëm, i mjaftueshëm dhe i ndjeshëm në planin afatshkurtër dhe afatgjatë, duke përfshirë kujdesin dentar, trajtimin mjekësor të specializuar kur nevojitet, dhe trajtimin për probleme shëndetësore kronike dhe të vazhdueshme.



**Mbështetje dhe këshillim psikologjik.** Mbështetje dhe këshillim psikologjik i përshtatshëm, i mjaftueshëm dhe i ndjeshëm në planin afatshkurtër dhe afatgjatë (për shembull, këshillim individual dhe në grup, terapi përmes artit, muzikës dhe kërcimit, këshillim familjar).



**Arsim, formim dhe aftësi për jetën.** Mundësi për arsim formal dhe joformal, duke përfshirë shkollim, mbështetje për rifutjen në shkollë, formim profesional, trajnim profesional, trajnim për aftësi jetësore, dhe tutorim, këshillim dhe orientim mbi trajnime profesionale.



**Mundësi për fuqizim ekonomik.** Mundësi për fuqizim ekonomik, duke përfshirë sistemimin në punë, stazhin, aktivite për gjenerimin e të ardhurave, zhvillim biznesi, këshillim dhe mentorim mbi mundësi punësimi dhe biznesi.



**Asistencë dhe mbështetje administrative.** Asistencë dhe mbështetje administrative e nevojshme për të adresuar ndikimin e trafikimit ose për të mbështetur riintegrimin (për shembull, marrja e dokumenteve të identifikimit ose dokumenteve të tjera zyrtare, certifikatës së lindjes, lejeve të banimit dhe punës si viktimat e trafikimit, dhe caktimi i një kujdestari ligjor në rastin e fëmijëve,

<sup>5</sup> Surtees, R. (2010) *Monitorimi i programeve të ri/integrimit kundër trafikimit. Manual*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni King Baudouin. Shihni edhe: Surtees, R. (2017) *Mbështetja e riintegrimin të personave të trafikuar. Udhëzues për Nënrajonin e Mekongut të Madh*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bangkok: UN-ACT dhe World Vision; dhe Surtees, R. et al. (2016) *Të shkojmë në shtëpi: Riintegrimi i viktimave të trafikimit në Indonezi*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS.

marrja e dokumenteve për akses në shërbime, si strehim me qira ose i subvencionuar, ndihmë ekonomike, shërbime sociale, sigurime shëndetësore).



**Asistencë dhe mbështetje juridike.** Asistencë dhe mbështetje për viktimat e trafikimit në procese ligjore, duke përfshirë procese gjyqësore penale, civile dhe lidhur me marrëdhëniet e punës. Asistenca dhe mbështetja juridike mund të jetë e lidhur me përvojën e tyre të trafikimit (për shembull, si viktimë-dëshmitar në procese gjyqësore penale, kërkesa për kompensim) ose me çështje të tjera ligjore të hasura gjatë riintegritimit (për shembull, divorci, aksesit ose kujdestaria e fëmijës, pronësia e pasurisë, pagesat e mbështetjes së fëmijës).



**Masa të sigurisë dhe sigurimit.** Masat për të garantuar sigurinë dhe sigurimin e viktimave të trafikimit në faza të ndryshme pas trafikimit, duke përfshirë vlerësime të familjes dhe rrezikut, mbrojtja e viktimës-dëshmitarit.



**Asistencë për pjesëtarët e familjes së viktimës.** Nxitje dhe mbështetje e një mjedisi të shëndetshëm familjar nëpërmjet formave të ndryshme të asistencës për pjesëtarët e familjes së viktimës (për shembull, fëmija, bashkëshorti/bashkëshortja, motra/vëllai, prindi).



**Menaxhimi i rastit.** Hartimi dhe zbatimi i një plani individual të asistencës dhe riintegritimit, në bashkëpunim me viktimën e trafikimit, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve ose koordinimin e referimit të viktimës në organizata/institucione të tjera për shërbime.



**Asistencë për kthimin.** Mbështetje për kthimin vullnetar të viktimave të trafikimit në shtetin e tyre dhe në vendin e origjinës ose banimit, duke përfshirë ofrimin e transportit dhe përgatitjen e dokumentacionit. Në disa raste, nevojat për asistencë janë rrjedhojë direkte e trafikimit.

## Tre fazat e rikuperimit dhe riintegritimit<sup>6</sup>

Riintegrimi pas përvojës së trafikimit është një proces afatgjatë që zgjat për shumë muaj dhe vite. Riintegrimi mund të zërthehet në tre faza të veçanta gjatë një periudhe rreth tre vjet.

### Tre fazat e riintegritimit



**Faza 1. Ndërhyrja gjatë krizës (nga 0 në 6 muaj).** Faza e krizës mund të zgjasë deri në gjashtë muaj, ndoshta edhe më shumë, në varësi të natyrës dhe shkallës së shfrytëzimit të individit, si dhe të sfidave dhe cenueshmërive para dhe pas trafikimit. Për shembull, zakonisht fëmijët kërkojnë më shumë kohë në fazën e krizës pasi kanë aftësi përballimi më pak të zhvilluara. Viktimat në rrezik për sigurinë (për shembull, për shkak se kanë denoncuar trafikantin e tyre) kërkojnë shpesh më shumë kohë në këtë fazë. Viktimat që janë gra shtatzëna ose të shoqëruara me fëmijët e tyre qëndrojnë zakonisht për periudha më të gjata kohore në këtë fazë krize, pasi kanë nevojë për mbështetje dhe shërbime gjatë periudhës para dhe pas lindjes, duke përfshirë aftësitë e prindërimit. Gjithashtu, ato kanë nevojë për mbështetje në trajtimin e traumës dhe qëndrueshmërinë e tyre emocionale, sidomos për të qenë në gjendje që të kujdesen për fëmijët e tyre. Shumë viktima me probleme të shëndetit mendor kanë nevojë për mbështetje më afatgjatë dhe më intensive në fazën e krizës, dhe shpesh edhe pas kësaj faze.



**Faza 2. Tranzicioni (nga 7 në 12 muaj).** Faza e tranzicionit zgjat zakonisht rreth gjashtë muaj (nga muaji i 7-të tek i 12-ti i procesit të riintegritimit). Megjithatë, kjo periudhë mund të jetë më e shkurtër në situatat kur viktimat kanë një profesion ose kanë përvojë të mëparshme pune, ose nëse kanë një mjedis të shëndetshëm familjar ku mund të kthehen. Por, mund të jetë edhe më e gjatë në rast se viktimat kanë nivel të ulët arsimor ose nuk kanë përvojë formimi profesional apo pune. Në përgjithësi, edhe fëmijët kanë nevojë për më shumë kohë në këtë fazë, kryesisht ata me marrëdhënie jo të mira me prindërit, ose ata që kanë marrëdhënie familjare të vështira ose të pashëndetshme.



**Faza 3. Riintegrimi dhe përfshirja (nga 13 në 36 muaj).** Faza e riintegritimit dhe përfshirjes zgjat zakonisht dy vjet, gjatë muajve 13-36, por varion nga njëra viktimitë te tjetra, dhe në varësi të përvojave të tyre jetësore specifike dhe të kushteve të riintegritimit. Disa viktima mund të lëvizin më shpejt gjatë fazës së riintegritimit dhe përfshirjes (për shembull, kur kanë një punë të qëndrueshme,

<sup>6</sup> Surtees, R. (2010) Monitoring anti-trafficking re/integration programmes. A manual. Washington, D.C.: NEXUS Institute and Brussels: King Baudouin Foundation.

mbështetje nga familja e tyre, një vend për të jetuar, një mjedis shoqëror të shëndetshëm dhe akses në shërbime komunitare).

Procesi i plotë i rikuperimit dhe riintegritimit (kriza, tranzicioni, dhe riintegrimi e përfshirja) zgjat zakonisht rreth tre vjet. Megjithëse kjo ndarje dhe afat kohor ofron një orientim të dobishëm, secila viktimë ka nevojë për periudha të ndryshme kohore për t'u rikuperuar dhe riintegruar pas një përvoje trafikimi. Disa viktima riintegrohen me sukses përpara përfundimit të kësaj periudhe trevjeçare. Viktima të tjera të trafikimit mund të kenë nevojë për pesë vjet që të rikuperohen nga shfrytëzimi i tyre, në mënyrë që të riintegrohen me sukses.

Profesionistët e riintegritimit duhet të jenë fleksibël në hartimin dhe zbatimin e çdo plani riintegrimi, duke përfshirë afatet e nevojshme kohore. Nevoja për një afat kohor më të gjatë për riintegrim është e zakonshme te viktimat “problematike” ose “komplekse”, pra te viktimat me vështirësi akute ose nevojave komplekse, ose që janë marrë më pak në konsideratë në kuadrin kundër trafikimit.<sup>7</sup> Këto mund të përfshijnë, por nuk kufizohen, viktima të trafikimit:

- ❁ Me aftësi të kufizuara fizike dhe/ose mendore
- ❁ Me probleme me abuzimin me substanca
- ❁ Me probleme të shëndetit mendor
- ❁ Me gjendje mjekësore të rëndë ose kronike
- ❁ Me probleme të sigurisë
- ❁ Pa dokumente ose status juridik
- ❁ Pa mbështetje familjare
- ❁ Që kanë pasur përvoja me të qenit të marginalizuar ose diskriminuar në aspektin social (duke përfshirë minoritete etnike, kombësi të ndryshme, dhe individë që identifikohen si (LGBTQ+)
- ❁ Me përvoja të shkuara të abuzimit, dhunës ose neglizhencës (veçanërisht në mjedis familjar)
- ❁ Që janë të shtatzëna ose që kanë fëmijë në varësi (veçanërisht prindërit e vetëm)
- ❁ Që nuk janë marrë mjaftueshëm në konsideratë në kuadrin kundër trafikimit (burra dhe djem të trafikuar)

“ Sa herë që ndihem në ankth, mendoj se të gjithë më tallin. Vetëm unë e di se sa po vuaj përbrenda. (I ri, viktimë e trafikimit që vuan nga depresioni)

Rastet “e vështira” ose “komplekse” kërkojnë shpesh akses në shërbime të shumëfishta dhe të vazhdueshme, kujdes të specializuar ose mbështetje intensive gjatë një periudhe më të gjatë se ajo e zakonshme, si dhe menaxhim më intensiv të rastit dhe/ose mbështetje afatgjatë për riintegrimin.

“ Unë kam edhe një problem shëndetësor serioz. Jam epileptike dhe askush nuk dëshiron të më punësojë. Madje edhe nëse e fsheh, jam pushuar sapa me kap kriza e parë. Zakonisht më kap kriza kur nervozohem... Në të vërtetë, nuk mund të gjej një vend pune. (E rritur, viktimë e trafikimit)<sup>8</sup>

<sup>7</sup> Surtees, R. (2007) Listening to victims. Experiences of identification, return and assistance in SE Europe. Vienna: ICMPD, NEXUS Institute & USAID, p. 211.

<sup>8</sup> For a discussion of reintegration of victims in difficult situations, please see: Surtees, R. (2008) Reintegration of trafficked persons. Handling “difficult” cases. Washington, D.C.: NEXUS Institute and Brussels: King Baudouin Foundation.

## Vështirësitë në procesin e riintegrit me kalimin e kohës

“Besi”<sup>9</sup> është një i ri që u trafikua për kryerjen e veprave penale kur ai ishte 15 vjeç. Ai u detyrua të vidhte dhe të shpërndante drogë. Sot, ai jeton me nënën dhe vëllanë e tij më të vogël në kushte të vështira. Nëna e tij punon shumë orë për të paguar qiranë, ushqimin dhe fatura të tjera për familjen. Edhe Besi punon, por duke qenë se vuan nga depresioni ai e ka të vështirë ta mbajë punën. Ai ndien një barrë të madhe presioni në jetën e tij të përditshme. Rasti i tij është kompleks për shkak të problemeve të tij të shëndetit mendor dhe përvojave të shkuara të abuzimit dhe neglizhencës. Të qenit i trafikuar si fëmijë ka ndikuar edhe në zhvillimin e shëndetshëm fizik dhe psikologjik, si dhe në aftësinë e tij për të krijuar marrëdhënie shoqërore të shëndetshme dhe mbështetëse. Mungesa e shërbimeve për burrat dhe djemtë e trafikuar ndikon më tej në mundësitë e tij për riintegrim të qëndrueshëm. Besi ka katër vjet që po asistohet. Ai vazhdon të ketë kontakte të rregullta me organizatën që ofron shërbime riintegruese ku mund të kërkojë ndihmë dhe mbështetje. Ai po përpiqet për të ecur përpara për riintegrimin e tij gjë që kërkon shërbime dhe mbështetje të vazhdueshme.

## Pengesat dhe sfidat e riintegrit

Riintegrimi kuptohet shpesh si proces linear, në të cilin viktimat bëjnë gradualisht hapa përpara drejt rikuperimit dhe riintegrit. Megjithatë, realiteti është shumë më kompleks. Shumë viktima trafikimi përballen me kriza dhe pengesa në faza të ndryshme gjatë riintegrit të tyre, të cilat mund të frenojnë progresin e tyre ose madje edhe të sjellin regres në hapat e mëparshëm të riintegrit. Krizat dhe vështirësitë e zakonshme në procesin e riintegrit përfshijnë, por nuk kufizohen në:


“ Kisha një vit që punoja si rrobaqepëse në një rrobaqepësi. Kur rrobaqepësia u mbyll për shkak të pandemisë së COVID-19, u gjenda në një situatë të vështirë pasi më duhej të ushqoja vajzën dhe veten, dhe të paguaja edhe qiranë e apartamentit. Kisha sërish nevojë për ndihmë me pako ushqimore dhe mbështetje financiare për pagesën e qirasë, në mënyrë që të mos dilja bashkë me vajzën në mes të katër rrugëve, pa pasur një vend për të qëndruar. (E rritur, viktimitë e trafikimit, e asistuar nga D&E)

- ❁ Vështirësitë ekonomike dhe krizën financiare, duke përfshirë mungesën e mundësive të punësimit ose humbjen e vendit të punës
- ❁ Problemet e shëndetit mendor që mund të shfaqen në faza të ndryshme
- ❁ Sëmundjet ose lëndimet që ndikojnë në mirëqenien ose aftësinë për punë
- ❁ Konfliktet, tensionet dhe mosmarrëveshjet në familje
- ❁ Dhunën dhe abuzimin në familje (dhuna në familje, abuzimi i fëmijëve, incesti)
- ❁ Tensionet dhe konfliktet me pjesëtarët e komunitetit
- ❁ Çështjet e sigurisë si viktimitë-dëshmitar (kërcënime dhe kanosje, kur trafikanti shpallet i pafajshëm ose del nga burgu)
- ❁ Procesin e gjatë gjyqësor dhe mungesën e aksesit efikas në drejtësi
- ❁ Problemet shëndetësore që prekin viktimat ose familjet e tyre (duke përfshirë ndikimin në kostot për kujdes shëndetësor)

<sup>9</sup>Të gjithë emrat janë ndryshuar për të ruajtur privatësinë e individëve të përfshirë.

- ❁ Përfundimin e asistencës së rregullt dhe mbështetjes e ndjekjes së riintegrit
- ❁ Vështirësitë e hasura nga disa përfitues për të qenë të pavarur dhe autonomë
- ❁ Ngjarjet e jashtme dhe krizat, duke përfshirë fatkeqësitë natyrore, si tërmetet dhe pandemitë botërore

### *Pengesat dhe sfidat gjatë procesit të riintegrit*



Në rastin e fëmijëve, pengesat mund të lindin nga vështirësitë në regjistrimin ose vazhdimin e arsimit, dhe nga mungesa e shërbimeve dhe procedurave specifike për fëmijën ose të ndjeshme ndaj fëmijës në nivel vendor. Në përgjithësi, fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë mund të jenë më të ekspozuar ndaj pengesave dhe krizave, për sa u përket kapaciteteve të tyre zhvilluese, identiteteve të tyre ende në zhvillim dhe varësisë së tyre të madhe nga familja dhe të rriturit e tjerë që kujdesen për ta. Po ashtu, fëmijët janë mjaft të cenusshëm ndaj hakmarrjes së trafikantëve dhe dhunës fizike dhe emocionale në përgjithësi, në mjedise të ndryshme (shtëpi, shkollë, komunitet).

“ Mendoj se përvoja e trafikimit është diçka që nuk do ta harroni kurrë. Ndhimja dhe mbështetja e bashkëshortit tim ishte shumë e dobishme. Nëse nuk do të më kishte mbështetur, mund të isha çmendur. Është shumë e rëndësishme që të keni një person të afërt që mund t’ju kuptojë dhe ndihmojë. (E rritur, viktimë e trafikimit)<sup>10</sup> ”

<sup>10</sup>Surtees, R. (2007) Listening to victims. Experiences of identification, return and assistance in SE Europe. Vienna: ICMPD, NEXUS Institute & USAID, p. 189.



Fakti nëse këto pengesa e devijojnë në mënyrë të përkohshme apo të përhershme procesin e riintegrit të përfituesit është një funksion i rrethanave të tyre individuale (mekanizmat e tyre individuale ose sociale të përbërësve) dhe i mbështetjes së disponueshme nëpërmjet programeve të riintegrit.

Të qenit në gjendje për t'u mbështetur te dikush në familjen ose rrjetin e vet shoqëror është pjesë përbërëse e të qenit në gjendje për të përballuar dhe kapërcyer problemet dhe pengesat që mund të lindin. Alternativa e kthimit për mbështetje dhe shërbime riintegrit në çdo fazë të jetës pas trafikimit të dikujt është e rëndësishme për të zbutur pengesat. Megjithatë mbështetja mund të jetë specifike për trafikimin, është e rëndësishme që të merren në konsideratë dhe të maksimizohen forma të tjera në nivel komunitar, si shërbime sociale të qeverisë qendrore, OJF vendore, organizata fetare dhe grupe komunitare.<sup>13</sup>

“ Kur isha në shtëpi me prindërit e mi, nuk kishim mjaftueshëm për të ngrënë dhe shikoja rrugëve dhe mendoja për zgjedhjet që kisha. Dhe rruga dukej si një mënyrë për të fituar para.. ( e rritur, viktime trafikimi)<sup>11</sup>

“ [Punonjësi social] më tha e kam gjithmonë derën të hapur... Më tha se mund të kthehesha në çdo moment. (Femër, viktime e trafikimit)<sup>12</sup>

## Kapërcimi i pengesave dhe krizave në riintegrit

“Maja” është një viktime e trafikimit që u asistua për të ngritur një biznes të vogël, për të fituar para dhe për të mbështetur familjen e saj. Biznesi po shkonte shumë mirë dhe ajo ishte e kënaqur me jetën e saj të përditshme. Megjithatë, pas një periudhe të shkurtër kohore, vjehri dhe vjehrra e saj kishin nevojë për kujdes mjekësor dhe asaj iu desh të përdorte para nga biznesi për trajtimin e tyre: “Organizata më ndihmoi për të ngritur biznesin tim të vogël, që kishte të bënte me shitjen e veshjeve të përdorura. Ajo ishte një periudhë e shkëlqyer në jetën time. Biznesi shkoi gjithnjë e më mirë gjatë gjithë vitit. Jam shumë mirënjohëse ndaj tyre, por nuk e mbajta fjalën për t'i investuar paratë në biznesin tim. Ndodhi që prindërit e bashkëshortit u sëmurën. Më duheshin para për trajtimin e tyre.” Maja kontaktoi organizatën ndihmese të cilët e ndihmuan për nevojat emergjente. Më pas u bë e mundur që ajo të kthente biznesin e saj në rrugën e duhur.<sup>14</sup>

Megjithatë procesi i riintegrit ndryshon nga njëri individ te tjetri, është e dobishme që profesionistët të kenë parasysh këto faza dhe afate kohore të përgjithësuar, si dhe specifikat e atyre që ndodhin në këto faza. Pjesët e mëposhtme trajtojnë secilën prej tre fazave të riintegrit, pra

<sup>11</sup> Surtees, R. (2007) *Duke dëgjuar viktimat. Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Evropën Juglindore*. Vjenë: ICMPD, Instituti NEXUS & USAID, f. 191.

<sup>12</sup> Surtees, R. (2007) *Duke dëgjuar viktimat. Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Evropën Juglindore*. Vjenë: ICMPD, Instituti NEXUS & USAID, f. 191.

<sup>13</sup> Surtees, R. (2008) *Riintegritimi i personave të trafikuar. Si mund të jetë më efektive puna jonë*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni i Mbretit Baudouin. Shihni edhe: Surtees, R. (2007) *Duke dëgjuar viktimat: Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Evropën Juglindore*. Vjenë: ICMPD, Instituti NEXUS & USAID, f. 188-89.

<sup>14</sup> Surtees, R. (2007) *Duke dëgjuar viktimat. Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Evropën Juglindore*. Vjenë: ICMPD, Instituti NEXUS & USAID, f. 208.

ndërhyrjen gjatë krizës, tranzicionin, riintegrimin dhe përfshirjen, duke përshkruar karakteristikat e çdo faze; ndjenjat dhe sjelljet e viktimave në çdo fazë; asistencën dhe mbështetjen e ofruar në çdo fazë; dhe udhëzimet për profesionistët e riintegrit.

## Faza 1. Ndërhyrja gjatë krizës (nga 0 në 6 muaj)



### Rreth fazës së krizës

Në përgjithësi, viktimat dalin nga trafikimi në një gjendje krize. Ato nuk janë mirë fizikisht, psikologjikisht dhe emocionalisht, dhe përballen me një sërë problemesh lidhur me situatën e tyre ekonomike, sigurinë fizike, statusin juridik, mungesën e akomodimit, situatën familjare, e kështu me radhë.

Kjo periudhë fillestare e ndërhyrjes pas përfundimit të trafikimit fokusohet te ndërhyrja gjatë krizës, për të ofruar mbështetje dhe mbrojtje të menjëhershme për adresimin e nevojave të menjëhershme dhe të ngutshme të viktimave, dhe stabilizimin e viktimës në mënyrë që ato të marrin vendime për riintegrimin e tyre. Duhet të caktohet një menaxher rasti (qoftë një punonjës social shtetëror apo një punonjës social nga një OJF) për të punuar me viktimat që në momentin e hyrjes dhe gjatë gjithë procesit të riintegrimin të tyre.

Disa viktimat të trafikuar jashtë vendit mund të asistohen gjatë fazës së krizës ndërkohë që janë ende jashtë vendit. Të tjerat kthehen në shtëpi menjëherë dhe bëhen pjesë e kësaj faze krize kur kthehen. Viktimat e shfrytëzuara në vendin e tyre do të kalojnë përmes kësaj faze krize në vendin e tyre.

Periudha e krizës zgjat zakonisht nga tre në gjashtë muaj, në varësi të situatës individuale dhe familjare të viktimës, si dhe përvojës së tyre të trafikimit.

Disa viktimat rikuperohen më shpejt menjëherë pas trafikimit dhe fillojnë kalimin në “jetën normale” pas disa muajsh. Të tjerat mund të kenë nevojë për më shumë kohë që të kapërcejnë dhe të përpunojnë atë që kanë ndodhur.

Viktimat me nevoja më komplekse (për shembull, me probleme të sigurisë, probleme të shëndetit mendor, gra shtatzëna ose me fëmijë në varësi) kërkojnë shpesh rreth gjashtë muaj ndërhyrje gjatë krizës përpara se të fillojnë tranzicionin. Në këtë fazë, asistenca duhet të jetë fleksibël, e përshtatur me nevojat e ngutshme dhe specifike të çdo viktime trafikimi.

“ Nuk e kisha menduar se do të dilja ndonjëherë nga kjo situatë, pasi jeta ime ishte shkatërruar dhe gjithçka po përkeqësohej. Babai nuk më shihte më në sy. Nëna qante në rajonin e policisë teksa dëgjonte historinë time. Isha gjallë, por doja të vdisja. Gjithsesi, isha shumë e vendosur për t'i shkuar deri në fund dhe për të bërë denoncimin. Madje edhe pas denoncimit isha shumë e frikësuar dhe shqetësuar për familjen time. (Vajzë e trafikuar brenda vendit për shfrytëzim seksual, e asistuar nga D&E)

“ Kur erdha për herë të parë në strehëz, në mendje më erdhën mendime të ndryshme. Isha shumë e dëshpëruar për atë që më kishte ndodhur. Mendoja se do të ishte më keq për mua pa njerëzit e mi, me rregulla dhe me njerëz të tjerë që nuk i njihja dhe me të cilët duhet të ndaja vendin e banimit. Kur hyra kisha ankth dhe shumë frikë në vetvete se mos isha mashtruar, dhe se ardhja në qendër mund të mos ishte vendimi i duhur. (Vajzë e trafikuar për shfrytëzim seksual, e asistuar nga D&E)

“ Disa prej tyre kanë dyshime, janë të frikësuar se si do të jetë, nëse gjatë këtij procesi do të jenë të sigurta, ato kanë mendime, shqetësime, frikë për pjesëtarët e familjes. Si do të ndikojë tek ato? Çfarë i pret ato, shumë pyetje, ankth, presion dhe mendime se si do të zhvillohen ngjarjet. (Punonjës social në D&E)

## Në fazën e krizës

“Eni” u trafikua jashtë vendit në moshën 17-vjeçare për shfrytëzim seksual. Kur u kthye në Shqipëri, ajo u akomodua në një strehëz. Ajo vuante nga probleme psikologjike serioze dhe e kishte të vështirë t’iu besonte njerëzve dhe të krijonte marrëdhënie të reja. Ajo ishte e tërhequr dhe vuante nga makthet dhe pagjumësia. Ajo kishte nevojë për mbështetje emocionale dhe psikologjike intensive për t’u stabilizuar pas përvojës së saj. Gjithashtu, ajo ndjente nevojën e ngutshme për të rifituar ndjenjën e kontrollit mbi jetën e saj, për t’u kthyer te familja e saj, për të vazhduar arsimimin dhe për të përparuar në jetën e saj. Por, situata e saj u ndërlikua për shkak të problemeve të sigurisë, pasi ajo dëshmoi në polici për trafikantin e saj, çka e bëri të pasigurt kthimin e saj në shtëpi. Nevoja për të qëndruar në strehëz, larg familjes së saj, ishte një burim stresi, siç ishte edhe pamundësia e saj për të rifilluar menjëherë arsimimin. *(Viktimë e trafikimit, e asistuar nga D&E)*



## Ndjenjat dhe sjelljet e viktimës në fazën e krizës

Në fazën e krizës, viktimat e trafikimit janë në përgjithësi ende të tronditura dhe të traumatizuara nga ajo çfarë kanë përjetuar, dhe përpiqen të përpunojnë gjithçka që iu ka ndodhur. Ato janë shpesh të frikësuar dhe të pasigurta se çfarë do të ndodhë më pas dhe se çfarë do të sjellë e ardhmja. Ato kanë shumë pyetje, shqetësime dhe frikëra. Është një periudhë me nivele të larta stresi, ankthi dhe traume, paqëndrueshmërie, izolimi dhe frike.

Viktimat ndikohen edhe fizikisht nga trafikimi, çka shton ndjenjat dhe reagimet negative. Gjatë kësaj periudhe, viktimat përballen shpesh me pengesa që cenojnë përpjekjet e tyre për t’u rikuperuar dhe për të bërë plane afatgjata, ose për të arritur qëllime të rëndësishme të jetës.

“**Isha e tërbuar kur flisja dhe pavarësisht se sa shumë [punonjësit socialë] më flisnin që të qetësohesha, e kisha të pamundur ta kontrolloja inatin. Qaja gjithë kohës. Më lëndonte shumë. (Grua, viktimë e trafikimit)<sup>15</sup>**”

Ndjenjat dhe sjelljet e zakonshme në fazën e krizës përfshijnë:

- Ankth, agresivitet dhe frustrim, duke përfshirë shpërthime, sjellje impulsive, agresivitet ndaj të tjerëve dhe vetes (lëndimi i vetes dhe tentativa për vetëvrasje)
- Rikthime në kujtesë dhe makthe për ngjarje traumatike
- Ankth, frikë, nervozizëm, duke përfshirë vështirësinë për t’u përqendruar
- Dyshim dhe mosbesim ndaj të tjerëve
- Reagime fizike (rrahje te forta të zemrës, tension muskolor, sulme ankthi)
- Mohim (mohimi se ka ndodhur trafikimi ose ngjarje të këqija gjatë trafikimit)
- Ndjenja kontradiktore (të dashurisë dhe urrejtjes ndaj trafikantëve dhe abuzuesve, veçanërisht kur trafikohen nga partneri ose bashkëshorti)
- Pesimizëm dhe kufizim i shpresës për të pasur një “jetë normale” (për t’u martuar, për të pasur një familje, për të pasur karrierë)
- Ndjenjë çlirimi (për ndryshimin e pritur në jetë)
- Probleme ose çrregullime të gjumit (pagjumësi, apnea e gjumit, parasomnia (çrregullime të gjumit), makthe)
- Gjendje emocionale e lartë ose e ulët

<sup>15</sup> Surtees, R. (2007) *Duke dëgjuar viktimat. Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Evropën Juglindore*. Vjenë: ICMPD, Instituti NEXUS & USAID, f. 145.

- ☘ Ndjesia e të qenit të pashpresë, duke përfshirë motivimin e ulët për rikuperim dhe riintegrim, dhe humbjen e interesit në aktivitetet e përditshme dhe në jetë në përgjithësi
- ☘ Ndjenja të fajit dhe turpit (për shkak se janë trafikuar, kanë dështuar në migracion, aktet e kryera ndërkohë që janë trafikuar)

Jo të gjitha emocionet dhe reagimet në faze krize janë negative. Viktimat shprehin edhe një ndjenjë çlirimi në fazën e krizës dhe shpresë për të filluar një fazë të re në jetën e tyre. Po ashtu, ato mund të jenë të emocionuara dhe shpresëplotë për t'iu rikthyer “jetës së tyre normale” dhe për të vazhduar jetën dhe planet e tyre, si dhe për të pasur mundësi të reja për rritje dhe zhvillim personal. Ato tregojnë shpesh forcë dhe të kuptuarit e rreziqeve, dhe se si t'i menaxhojnë ato. Shumë prej tyre janë mirënjohëse dhe të çliruara kur kanë ndihmë dhe mbështetje (për shembull, nga një organizatë ose institucion asistues, apo familja e tyre). Kjo është mjaft e rëndësishme kur viktimat nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë të kontaktojnë me familjen dhe të afërmit e tyre (të paktën në fazat fillestare të rikuperimit dhe riintegrimin).

Emocionet dhe reagimet e viktimave mund të jenë konfliktuale dhe kontradiktore. Për shembull, nuk është e pazakontë që një viktimë të kalojë nga emocionet dhe reagimet pozitive tek ato negative, pasi përpiqet të kapërcejë përvojën e saj të shfrytëzimit. Një viktimë mund të jetë thellësisht e çliruar dhe e lumtur për të qenë në shtëpi me familjen e saj, por, në të njëjtën kohë, përpiqet të menaxhojë inatin dhe frustrimin e saj për atë që i ka ndodhur, duke e bërë që ta nxjerrë inatin te të njëjtët pjesëtarë të familjes, për të cilët ajo është e lumtur që u ribashkuan. Disa viktimat mund të jenë të inatosura me pjesëtarët e familjes së tyre që i kanë nxitur ose detyruar të migrojnë, çka ka sjellë trafikimin e tyre.

Po ashtu, disa viktimat kanë ndjenja kontradiktore për shfrytëzuesit dhe trafikantët e tyre, sidomos nëse ata janë të dashurit, partnerët ose bashkëshortët e tyre. Ato mund të jenë të frikësuar dhe të inatosura me ta, por mund të ndiejnë edhe një lidhje emocionale me ta, gjë që ndërlikon daljen nga trafikimi dhe vullnetin për të treguar plotësisht se çfarë iu ka ndodhur në duart e tyre.

“ Prindërit më ushtronin gjithmonë e më shumë presion për t'u larguar nga vendi dhe për t'u martuar, pasi, sipas tyre, isha shumë e madhe, edhe pse isha vetëm 19 vjeç. Një i afërm më gjeti një burrë nga i cili mori edhe një pagesë. Ne nuk u martuam kurrë ligjërisht dhe qëllimi i tij ishte të më përdorte për të mbajtur shtëpinë dhe për të rritur fëmijët që ai kishte nga një marrëdhënie tjetër, ndërsa vetë ai nuk punonte, konsumonte drogë dhe alkool. Pas një periudhe dhune dhe shfrytëzimi, u ktheva në shtëpi. Isha e lumtur të kthehesha në familje, edhe pse isha ende nën presion nga prindërit (Vajzë e trafikuar, martese me detyrim, e asistuar nga D&E).

“ Gjatë kohës që abuzohesha dhe shfrytëzohesha, i thoja shpesh vetes se ajo që po më ndodhte nuk ishte fundi i botës. Se ishte diçka që mund ta përballoja dhe se i dashuri do të më kuptonte se e doja me gjithë zemër, se e bëra për të... (Vajzë e trafikuar për shfrytëzim seksual nga i dashuri, e asistuar nga D&E)

Shumë viktime e justifikojnë sjelljen e vrazhdë dhe agresive të trafikantëve të tyre pasi pretendojnë se i donin dhe kujdeseshin për to.

“ Është shumë e vështirë ta kuptoj, e urrej kaq shumë dhe sërish e dua, njëkohësisht mendoj pafund për të. Kam fajësuar veten me shpresën se ai do të ndryshonte. (Vajzë e trafikuar për shfrytëzim seksual nga i dashuri, e asistuar nga D&E)

”

### Ndjenjat dhe sjelljet e viktimave në fazën e krizës

“Marija” u trafikua për shfrytëzim seksual kur ishte 17 vjeç. Kur e kishte të mundur që të arratisë nga situata e saj e trafikimit dhe të kthehej në Shqipëri, ajo u përball me shumë vështirësi dhe stres. Ajo ishte e lodhur fizikisht dhe emocionalisht, dhe ndjente peshën e shumë përgjegjësive në jetën e saj. Ajo jetonte vetëm me vajzën e saj 4-vjeçare, e cila u lind nga trafikimi, dhe ishte përgjegjëse për t’u kujdesur për veten dhe fëmijën e saj në çdo aspekt të jetës. Marija ishte thellësisht e shqetësuar nga ajo që i kishte ndodhur, dhe nga vështirësitë dhe traumat e shumta që kishte hasur në jetën e saj përpara trafikimit. Menjëherë pas trafikimit, Marija ishte e tërhequr dhe emocionale, shpesh qante, ndihej e pashpresë dhe e pamotivuar për të ecur përpara. Ajo ndihej në faj dhe stres për papërshtatshmërinë e saj si prind. Marija mori asistencë psikologjike për rreth gjashtë muaj, periudhë gjatë së cilës gjendja e saj psikologjike dhe emocionale u stabilizua. Ndjenjat e saj të trishtimit, mungesës së shpresës, fajit dhe ankthit u zbehën gradualisht dhe ajo ndihej gjithmonë e më shumë e qetë dhe e motivuar. Ajo i përmirësoi ndjeshëm aftësitë e saj të prindërimit dhe marrëdhënien me vajzën e saj.




### Asistenca dhe mbështetja e nevojshme në fazën e krizës

Një menaxher rasti (punonjësi social shtetëror ose punonjësi social nga një OJF e caktuar) duhet të caktohet për të punuar me secilën viktimë që në momentin e hyrjes dhe gjatë gjithë procesit të riintegrit të tyre. Menaxheri i rastit mbështetet nga një ekip multidisiplinar (EMD), duke përfshirë:

- punonjës social (si menaxheri i rastit),
- psikolog,
- mjek,
- avokat,
- mësues.

## *Ekipi multidisiplinar (EMD) për mbështetjen dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit*



EMD-ja kryen një vlerësim gjithëpërfshirës të nevojave në diskutim me viktimen për të hartuar dhe ndjekur planin individual të riintegrimin. Vlerësimi i nevojave kryhet nga EMD-ja brenda dy javësh pas pranimit të viktimave në program, dhe plani individual i riintegrimin hartohet nga menaxheri i rastit dhe viktimave brenda një muaji. Ky proces përfshin jo vetëm identifikimin e nevojave dhe sfidave, por edhe burimet personale ku mund të bazohen për të mbështetur riintegrimin e tyre. Gjithashtu, kërkohet caktimi i detyrave për agjenci dhe punonjës të veçantë, si dhe vendosja e afateve kohore për përfundimin, dhe identifikimi i treguesve të suksesit për të vlerësuar zbatimin e planit të riintegrimin. Përfituesi dhe punonjësi i rastit nënshkruajnë planin për të treguar se të dyja palët janë të angazhuara për realizimin e tij. Në rastin e përfituesve nën 18 vjeç, plani nënshkruhet nga prindi ose kujdestari ligjor.<sup>16</sup>

Në bazë të nevojave të viktimës, anëtarët e EMD-së bashkëpunojnë me institucione dhe organizata të ndryshme për të pasur akses në shërbime. Për shembull, mësuesi bën vlerësimin arsimor/edukativ të përfituesit, duke përfshirë alternativat për rifutjen në arsimin formal ose aksesin në programe ekuivalente, dhe bashkëpunon me institucionet përkatëse për të maksimizuar mbështetjen e duhur. Këtu mund të përfshihet ofrimi i dokumenteve dhe diplomave të shkuara pranë institucioneve përkatëse, duke sensibilizuar stafin e shkollës, dhe koordinimi me punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në rastin e fëmijëve.

“ Isha në rajonin e policisë dhe më thanë se do të më çonin diku ku do të isha e sigurt dhe mirë. Erdhën dhe më çuan në strehëz, një zonjë e sjellshme më dha disa rroba të reja dhe artikuj të higjienës personale, ajo më tha se mund të kërkosh gjithçka që të duhet. Po ndihesha shumë keq për gjithçka që më kishte ndodhur. Pata një bisedë me një psikolog, më pas më vizitoi një mjek, ishte diçka e mirë sepse kisha paretat në pjesën intime, për të cilën nuk i kisha treguar askujt më parë. Nuk kisha shkuar

<sup>16</sup> Për udhëzime mbi kryerjen e vlerësimit të nevojave dhe hartimin e planit të riintegrimin, ju lutemi shihni: Të Ndryshëm & Të Barabartë (2020) *Manual për menaxhimin e rasteve të viktimave të trafikimit në Shqipëri*. Tiranë, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë.

Asistenca gjatë fazës së krizës ofrohet zakonisht në kuadër të qendrës rezidenciale, për një periudhë prej tre deri në gjashtë muaj, në bazë të nevojave individuale të viktimës. Shumica e viktimave të trafikimit e kanë të pamundur të kthehen menjëherë në familjet e tyre për shkak të problemeve të sigurisë, të stigmës dhe diskriminimit nga familja dhe komuniteti. Për rrjedhojë, qendra rezidenciale ofron një mjedis të sigurt dhe mbështetës për viktimat në këtë fazë fillestare të krizës dhe rikuperimit.

**kurrë të mjehtu për këtë arsye. E kam kuruar problemin tim, më bëri të ndihem më mirë. (Vajzë e trafikuar për shfrytëzim seksual, e asistuar nga D&E)**

”

Megjithatë, disa viktimat mund të mos kenë nevojë ose të mos duan të përfshihen në programin rezidencial. Në këtë rast, ato mund të asistohen për t'u akomoduar në vende të tjera. Këtu mund të përfshihen:

- në shtëpi me familjen e tyre (për shembull, nëse kanë marrëdhënie familjare të shëndetshme dhe mbështetëse, nuk kanë probleme të sigurisë dhe familja nuk është e përfshirë në trafikimin e tij/saj);
- në shtëpi më vete (për shembull, nëse janë të rritur dhe nuk kanë probleme të sigurisë);
- programe rezidenciale të specializuara në asistimin e viktimave me nevoja të veçanta (për shembull, kur viktimat kanë aftësi të kufizuara mendore ose fizike, kanë probleme të shëndetit mendor).

Në këto raste, asistenca iu ofrohet viktimave në partneritet me institucione dhe organizata të ndryshme në zonën ku ato janë akomoduar, dhe menaxherët e rastit i monitorojnë viktimat nëpërmjet vizitave në shtëpi ose telefonatave të rregullta. Shërbimet sociale shtetërore, duke përfshirë njësitë e mbrojtjes së fëmijës në rastin e fëmijëve të trafikuar, luajnë një rol të rëndësishëm, jo vetëm në ofrimin e shërbimeve por edhe në kryerjen e monitorimit dhe ndjekjes.

Asistenca e ofruar në këtë fazë të krizës fokusohet te stabilizimi fillestar i viktimave dhe te plotësimi i nevojave të tyre të menjëhershme – për shembull, strehim dhe nevojat bazë (veshje, ushqim).

Shumë viktimat vijnë nga familje që nuk kanë një shtëpi ose akomodim të qëndrueshëm, ose të cilat nuk mund të kthehen menjëherë për të jetuar me familjen. Disa viktimat kanë jetuar në rrugë ose në institucione, çka do të thotë se nuk kanë një vend ku të jetojnë pas trafikimit. Për rrjedhojë, shumë viktimat në periudhën e krizës janë akomoduar në strehëza për viktimat e trafikimit. Aksesimi i alternativave për strehim për meshkujt viktimat të trafikimit është më i ndërlikuar, pasi strehëzat për meshkujt nuk janë lehtësisht të disponueshme dhe disa meshkuj shfaqin rezistencë për t'u asistuar në strehëza. Në këtë rast, meshkujt akomodohen në apartamente me qira.

“**Në fillim, gjëja më ndihmuese ishte biseda rreth historisë sime personale me psikologun dhe punonjësin tim social. Të folurit me ta ishte shumë i dobishëm dhe i këndshëm për mua, më ndihmoi dhe më bëri të ndihem më mirë. Mjedis i krijuar për mua ishte shumë i ngrohtë dhe më ndihmoi të isha në paqe. Mora pjesë në aktivitete të ndryshme që organizoheshin brenda dhe jashtë qendrës. Shkova në shkollë dhe mësova se si të shkruaj dhe të lexoj. Më pas, ndoqa një trajnim për punësim që më ndihmoi të shtoja aftësitë e mia. (E re, e trafikuar për shfrytëzim seksual, e asistuar nga D&E)**

”

Nevojat e tjera të ngutshme dhe prioritare përfshijnë:









- Kujdes mjekësor (për të trajtuar sëmundjet dhe lëndimet e pësuar gjatë trafikimit, si dhe çdo problem mjekësor që ekzistonte përpara trafikimit)



- ✓ Asistencë psikologjike (për të ndihmuar viktimat që të stabilizohen dhe të fillojnë të kapërcejnë përvojën e tyre)
- ✓ Mbrojtje dhe siguri (në rastin e viktimave që përballen me rreziqe nga trafikantët)
- ✓ Asistencë administrative (për të përpunuar dokumentet dhe aksesuar shërbimet)
- ✓ Asistencë dhe mbështetje ligjore (për nevoja ligjore lidhur ose jo me trafikimin)
- ✓ Ndërmjetësim familjar (për të filluar komunikimin ndërmjet viktimës dhe familjes së tij/saj)

Disa viktimë mund të marrin lloje të tjera mbështetjeje në këto faze, si trajnime profesionale ose rifutje në shkollë, por kjo varet nga situata individuale.

Faza e krizës karakterizohet nga disa arritje kryesore. Megjithatë kjo ndryshon nga njëri person te tjetri, disa etapa të zakonshme përfshijnë:

-  Pranimin e situatës së vet jetësore; gjetjen e kuptimit dhe qëllimit në jetën e vet të re
-  Krijimin e një rutine dhe ritmi të ri të jetës
-  Reduktimin e traumës dhe vështirësive emocionale; suksesin në kapërcimin e përvojës së trafikimit
-  Përmirësimin e mirëqenies fizike dhe psikologjike, duke përfshirë vetëbesimin dhe autonominë personale
-  Aftësinë për të menaxhuar mjedisin përreth
-  Aftësinë për të shfaqur empati, afeksion dhe afritet
-  Përmirësimin e marrëdhënieve familjare dhe shoqërore në përgjithësi
-  Mundësinë për të qenë të mbrojtur dhe të sigurtë.

### Asistenca dhe mbështetja e nevojshme në fazën e krizës

“Lea” është 25 vjeçe. Në moshën 19-vjeçare, ajo u trafikua jashtë vendit nga i dashuri i saj. Ajo u kthye në shtëpi shtatzënë nga trafikimit. Ajo u mbështet dhe akomodua në strehëz për shkak të problemeve të sigurisë (rrezik nga ish i dashuri/trafikanti i saj), si dhe problemeve familjare (prindërit dhe vëllezërit nuk e pranonin dhe e fajësonin si për shfrytëzimin seksual, ashtu edhe për shtatzëninë). Ajo u asistua me kujdes shëndetësor, iu kushtua vëmendje e veçantë shtatzënisë dhe kujdesit para lindjes, si dhe kujdesit gjatë dhe pas lindjes së foshnjës. Ajo u mbështet edhe për të zhvilluar aftësitë lidhur me kujdesin ndaj fëmijës dhe prindërimin. Po ashtu, ajo mori këshillim psikologjik, çka e ndihmoi për të kapërcyer traumën dhe për të stabilizuar gjendjen e saj psikologjike dhe emocionale. Ishte gjithashtu e rëndësishme për aftësinë e saj për të kapërcyer stresin pas lindjes. Gjithashtu, ajo përfitoi asistencë ligjore të vazhdueshme, pasi dha dëshminë për trafikantin e saj në polici dhe u përball me shqetësime për sigurinë. Ndërmjetësimi dhe përmirësimi i marrëdhënieve me familjen e saj ishte pjesë tjetër e rëndësishme e asistencës së saj në fazën e krizës. Kjo asistencë e ndihmoi për të përmirësuar marrëdhënien me familjarët e saj, sidomos me babanë dhe vëllezërit. Ajo komunikoi rregullisht me familjen e saj në telefon dhe i takon ata kur vijnë për ta vizituar në qytet.

### Çështje dhe konsiderata të veçanta në ndihmën e fëmijëve të trafikuar në fazën e krizës

- ***Të ndjerit i sigurt:*** Plotësimi i nevojave bazë të fëmijës (veshje, ushqim, strehim, higjienë) i jep fëmijës ndjesinë e te mot qenit vetem dhe se ka persona te të cilët ai mund të mbështetet.
- ***Kapërcimin e përvojave traumatike:*** Fëmijët e kanë më të vështirë se të rriturit që të kapërcejnë traumën e shkaktuar nga trafikimi i tyre, pasi janë ende në zhvillim. Fëmijët duhet të dinë se është dikush që gjendet pranë tyre dhe që i dëgjon, dhe që do i ndihmojë për të kapërcyer ngjarjen e tyre traumatike. Kur një fëmijë është gati të flasë për atë çfarë i ka ndodhur, duhet të jetë i pranishëm një profesionist, si psikologu ose punonjësi social, dhe e mira do të ishte që ky person të ishte dikush i trajnuar në punën me fëmijët.
- ***Krijimin e besimit dhe nevojën për kohë:*** Gjatë kësaj faze, fëmija mund të tërhiqet dhe të ndihet i pasigurt. Është e rëndësishme që fëmija të ndihmohet për t'u lidhur me të tjerët dhe për të krijuar besim. Po ashtu, ka rëndësi që fëmijës t'i jepet kohë për t'u qetësuar dhe kapërcyer traumën e tyre, duke përfshirë ndjenjat e tyre të ndryshme të turp, fajit, konfuzionit dhe braktisjes.
- ***Caktimin e një kujdestari ligjor:*** Disa prindër ose të afërm janë bashkëfajtorë në shfrytëzimin e fëmijës, duke e bërë të nevojshme heqjen e kujdestarisë prindërore dhe caktimin e një kujdestari ligjor për fëmijën. Caktimi i një kujdestari ligjor nevojitet edhe kur fëmijët janë jetimë ose pa kujdes prindëror (duke përfshirë rastet kur një prind ka probleme të shëndetit mendor). Në rastin e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror, duhet të caktohet një kujdestar ligjor për të vepruar në interesin më të lartë të fëmijës. Cdo hap i ndërmarrë në këtë fazë dhe shërbimet e ofruara realizohen në bashkëpunim të ngushtë me kujdestarin ligjor të fëmijës.
- ***Kohëzgjatjen më të madhe të kujdesit:*** Në rastin e fëmijëve të trafikuar, faza e krizës është më e gjatë dhe kërkon më shumë shërbime. Kjo ndodh për shkak të traumave konstante, të rënda dhe të patrajtuara në fëmijëri. Ndonjëherë, pas kthimit në shtëpi, situata e tyre përkeqësohet dhe kanë nevojë për mbështetje afatgjatë për vete dhe familjet e tyre. Në përgjithësi, ata kanë nivele të ulëta arsimimi dhe mangësi të tjera zhvillimore, si pasojë e trafikimit dhe shfrytëzimit që kërkojnë kohë për t'u trajtuar.

### **Konsiderata të veçanta për fëmijët viktime të trafikimit në fazën e krizës**

“Ana” u trafikua kur ishte fëmijë. Ajo e kishte të pamundur të kthehej në shtëpi për shkak të mjedisit familjar jo të shëndetshëm, mamaja e saj vuante nga semundje të shëndetit mendor dhe ishte abuzuar nga babai dhe vëllai i saj. Rrjedhimisht, ajo u asistua përkohësisht në një strehëz gjatë fazës së krizës, pasi nuk mund të jetonte e pavarur. Opsione të ndryshme u shqyrtuan nga punonjësi i rastit dhe morën në konsideratë situatën e saj si fëmijë pa kujdes prindëror dhe pa mbështetje. Xhaxhai i saj ra dakord të merrte kujdestarinë e Anës dhe ajo ishte në gjendje të jetonte me xhaxhanë dhe me familjen e tij.

## Çështjet kryesore në fazën e krizës Udhëzime për profesionistët

Profesionistët e riintegritit luajnë një rol kritik, shpesh jetëshpëtues në jetën e viktimave të trafikimit në këtë fazë krize. Më poshtë, paraqiten disa udhëzime dhe orientime kyç për profesionistët për t'i mbështetur ata në punën e tyre të përditshme.

- Jini të vetëdijshëm se faza e krizës është një periudhë e vështirë për viktimat e trafikimit.** Ato shfaqin një larmi emocionesh dhe reagimesh pozitive dhe negative. Intensiteti i reagimeve dhe emocioneve të viktimës varet shumë nga njëri përfitues te tjetri. Këto reagime janë normale pasi ata kapërcejnë ngjarjet e tyre traumatike të jetës.
- Jini të qetë, të duruar dhe mirëkuptues ndaj reagimeve dhe sjelljeve të përfituesit në këtë periudhë krize.** Këto reagime dhe sjellje nuk ju drejtohen ju personalisht. Flisni me supervizuesin për ndjenjat tuaja kur këto reagime dhe sjellje janë shqetësuese ose konfuze.
- Jini të duruar.** Koha që mund t'ju duhet gjatë fazës së krizës mund të variojë shumë nga njëri përfitues te tjetri.
- Punoni me secilin përfitues për të bërë një vlerësim të nevojave, duke identifikuar se çfarë nevojash kanë, dhe çfarë lloji mbështetjeje dhe shërbimesh do të kërkojnë për ta përmbushur këtë nevojë.** Merrni kohën e nevojshme për ta kryer këtë vlerësim të nevojave, duke e lejuar përfituesin të mendojë dhe të reflektojë mbi këtë proces. Identifikoni nevojat e reja që lindin gjatë fazës së krizës. Diskutojini ato me përfituesin dhe përfshijini këto nevoja dhe shërbime në planin e riintegritit.
- Në bazë të vlerësimit të nevojave, punoni bashkë me përfituesin për hartimin e planit të tij të riintegritit, me fokus të veçantë në fazën fillestare të krizës.** Sigurohuni që plani i riintegritit të jetë realist dhe i arritshëm, me qëllime të identifikuara në intervale kohore specifike.
- Asistenca dhe shërbimet duhet të përshtaten me nevojat specifike të çdo viktime në fazën e krizës.** Shqyrtoni me kujdes se cilat shërbime do të përgjigjen dhe trajtojnë nevojat e viktimës. Bashkëpunoni me institucione dhe organizata të ndryshme për të siguruar që viktimat të kenë akses në këto shërbime.
- Merrni pëlqimin e informuar me shkrim nga viktimat për planin e tyre të riintegritit dhe për shërbime të ndryshme që mund të marrin.** Sigurohuni që ata të kuptojnë se e gjithë asistenca (në të gjitha fazat e riintegritit) është vullnetare dhe se ata mund ta tërheqin pëlqimin e tyre në çdo moment.

**Jini të qartë në komunikimin tuaj me përfituesin, duke marrë kohën e nevojshme për të siguruar që ata të informohen plotësisht për të gjitha aspektet e rikuperimit dhe riintegrit të tyre, dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë asaj që po ndodh aktualisht në fazën e krizës.** Ofrojuni atyre informacion me shkrim mbi asistencën në një format që është i kuptueshëm, i aksesueshëm dhe i përshtatshëm për moshën. Nxitini të bëjnë pyetje sa herë që duan dhe për çdo aspekt të asistencës dhe riintegrit. Komunikoni rregullisht me viktimat lidhur me progresin e planit të tyre të riintegrit, dhe punoni bashkërisht për të bërë përshtatje, duke përfshirë aksesimin e shërbimeve shtesë.

**Përfshijeni përfituesin në të gjitha vendimet mbi opsionet e asistencës dhe informojeni për çdo përshtatje apo ndryshim të nevojshëm.** Merrni në konsideratë edhe mundësi alternative në rast se përfituesi dëshiron të bëjë ndryshime në planin e tij.

**Punoni ngushtë me kolegët tuaj të ekipit multidisiplinar (EMD-së) për identifikimin e nevojave të viktimave, si dhe të mundësive për mbështetje dhe shërbime.** Jini të hapur ndaj këshillave, udhëzimeve dhe sigurisë nga kolegët tuaj të EMD-së, pasi të gjithë mund të mësojmë nga njëri-tjetri, duke përfshirë rastet kur ia kemi dalë me sukses, si dhe ato kur kemi dështuar.

**Mbani parasysh se jeni pjesë e një ekipi dhe se nuk do e përballoni të vetëm këtë punë sfiduese.** Mbështetuni te kolegët tuaj për udhëzime, sugjerime dhe mbështetje. Komunikoni me supervizorin tuaj për çdo problem dhe shqetësim që hasni, dhe punoni me të për të gjetur zgjidhje dhe opsione.

**Sigurohuni që qasja juaj në punën me viktimat të jetë e përqendruar tek viktimat, me ndjeshmëri ndaj gjinisë, miqësore me fëmijën, e përshtatshme në aspektin kulturor dhe e informuar për traumat.** Kërkoni udhëzime dhe mbështetje nga supervizori dhe kolegët për t'u siguruar se ky është rasti. Jini të hapur ndaj sugjerimeve se si mund të zbatohen këto qasje në praktikë.

**Ruani privatësinë dhe konfidencialitetin e përfituesit, dhe jini të qartë se kur menaxhimi i rastit mund të kërkojë diskutimin e rastit me profesionistë të tjerë.** Merrni pëlqimin e informuar të përfituesit kur informacioni i dosjes së rastit ndahet me profesionistë të tjerë, dhe sigurohuni që këta profesionistë të respektojnë kërkesat e konfidencialitetit.

**Jini të vetëdijshëm se puna me fëmijët e trafikuar në këtë fazë mund të jetë më intensive dhe e vështirë.** Punoni ngushtë me punonjësit e mbrojtjes së femijeve në këtë fazë.

**Sigurohuni që të gjitha vendimet në rastin e një fëmije të trafikuar të jenë në interesin më të lartë të fëmijës.**

**Përfshijeni fëmijën për vlerësimin e nevojave dhe zhvillimin e panit të riintegrit.** Diskutoni paraprakisht çdo vendim me fëmijën. Sigurohuni që të gjitha masat të merren me pëlqimin e prindit (ose kujdestarit ligjor) dhe e mira do të ishte edhe me pëlqimin e fëmijës.

## Faza 2. Faza e tranzicionit (nga 7 në 12 muaj)



### Rreth fazës së tranzicionit

Faza e krizës pasohet nga një periudhë stabilizimi dhe tranzicioni, gjatë së cilës viktimat fillojnë të bëjnë kalimin drejt “jetës normale”. Në këtë fazë, në përgjithësi viktimat janë rikuperuar fizikisht nga trafikimi, duke përfshirë lëndimet ose sëmundjet, dhe janë mirë fizikisht. Në përgjithësi, ato i kanë pranuar (ose të paktën kanë filluar të kapërcejnë) përvojat e tyre traumatike, dhe kanë zhvilluar aftësi për t’i menaxhuar ato. Ato kanë krijuar një ritëm dhe rutinë të përditshme të shëndetshme të jetës, kanë përmirësuar aftësitë për jetën dhe marrëdhëniet ndërpersonale. Zakonisht, kanë plane konkrete dhe realiste për të ardhmen e tyre dhe punojnë për t’i përmbushur ato qëllime.

Viktimat kanë punuar edhe për të përmirësuar marrëdhëniet familjare dhe mund të jenë në gjendje që të kthehen në shtëpi për të jetuar me familjet e tyre, ose që të mbajnë kontakte të rregullta me ta. Disa mund të jenë kthyer për të jetuar me familjarët e tyre në shtëpi, ndërsa të tjerat mund të mbështeten në formën e jetesës gjysmë të pavarur në apartamente, ose të jetojnë të pavarura. Përfituesit janë gjithmonë e më shumë përgjegjës për veten, ndërkohë që ofruesit e shërbimit i mbështetin në këtë proces.

“**Kam qenë në qendër për disa muaj, koha po kalon shpejt, po ndjek kurse profesionale, po mendoj se si të ndërtoj një të ardhme të qëndrueshme për veten. Ndonjëherë ndjej inat dhe dhimbje. Dëgjoj muzikën time të preferuar, përpiqem të çlodhem dhe të punoj mbi mendimet e mia. Kam mësuar që t’iu jap përgjigjen e duhur mendimeve të mia, atë realen, e cila më përkufizon mua për atë që jam dhe që dua të jem. (E re, viktimë e trafikimit, e asistuar nga D&E)**

Shumë viktimat kanë kaluar përmes kësaj faze krize në Shqipëri dhe kjo do të jetë vazhdim i procesit të riintegritimit. Megjithatë, disa viktimat janë asistuar në fazën e krizës ndërkohë që kanë qenë jashtë vendit, dhe kthehen në shtëpi gjatë fazes së tranzicionit. Kjo ka gjasë të përfshijë rishqyrtimin e disa hapave nga faza e krizës. Zakonisht, kjo fazë zgjat rreth gjashtë muaj (muajt 7-12 të procesit të riintegritimit), por mund të jetë më e gjatë, në varësi të situatës personale, familjare dhe komunitare të individit. Kjo fazë fillon zakonisht pas gjashtë muajsh nga ndërhyrja gjatë krizës, por për disa viktimat mund të fillojë më herët, pas disa muajsh nga dalja nga trafikimi.

### Në fazën e tranzicionit

“Aria” vjen nga një qytet i vogël i Shqipërisë. Ajo u trafikua jashtë vendit për shfrytëzim seksual kur ishte 17 vjeç. Pasi u shkeput nga situata e trafikimit, ajo u asistua në një strehëz gjatë fazës së krizës për të kapërcyer traumën e saj dhe për t’u rikuperuar fizikisht, si dhe për të hartuar një plan për riintegritimin. Ajo ka mbaruar shkollën e mesme dhe tani punon. Ajo po ndjek një kurs parukerie, në mënyrë që të bëhet një parukiere profesioniste. Ajo shpreson që së shpejti të kthehet dhe të jetojë me familjen e saj. Ajo e ka vizituar disa herë familjen e saj, veçanërisht gjatë pushimeve dhe ka qëndruar një ose dy ditë. Megjithëse e ka përmirësuar ndjeshëm marrëdhënien me familjen e saj, ajo ndjen se fqinjët dhe njerëz të tjerë në qytet flasin për të. Familja e saj nuk ndihet rehat me reagimin e komunitetit kur ajo i viziton. Aria e kupton se është ende herët që të kthehet për të jetuar me familjen e saj dhe të përpiqet të rindërtojë jetën e saj atje. Mendësia e njerëzve në komunitetin e saj është shumë gjykuese dhe nevojitet më shumë kohë që kjo të lihet mënjanë. Megjithëse kjo e bezdis, ajo e kupton se nuk mund ta ndryshojë situatën dhe tani për tani do të qëndrojë në kryeqytet.



## Ndjenjat dhe sjelljet e viktimave në fazën e tranzicionit

Faza e tranzicionit kategorizohet nga qëndrueshmëria emocionale dhe psikologjike, gjatë së cilës viktimat janë më të afta për të kapërcyer dhe menaxhuar reagimet e tyre emocionale. Përfituesit mësojnë se si të sillen dhe ndërveprojnë në situata komplekse, duke përfshirë përbalimin e konfrontimit dhe tensionit, menaxhimin e ndjenjave dhe reagimeve negative, dhe fokusimin konstruktiv të energjisë së tyre. Përfituesit duhet të nxiten dhe mbështeten për të pranuar përvojën e tyre të trafikimit dhe për të punuar për krijimin e një jete më të mirë, në përputhje me talentin, aftësitë dhe mundësitë e tyre. Në përgjithësi, përfituesit ndihen mirë në këtë fazë. Ata janë të lumtur, entuziastë dhe të emocionuar për të përparuar në jetën e tyre, për të jetuar të pavarur, për të provuar gjëra të reja dhe për të filluar jetën e tyre të re.

Në të njëjtën kohë, ata ndihen shpesh të frikësuar dhe kanë dyshime mbi aftësitë e tyre për të menaxhuar vetë jetën, duke përfshirë të qenit në gjendje për të gjetur dhe mbajtur një punë, pasjen e aftësive jetësore të zhvilluara mjaftueshëm, ose të qenit në gjendje për të pasur marrëdhënie pozitive dhe të shëndetshme. Ata mund të ndihen të pasigurtë për të ardhmen e tyre, duke pasur parasysh problemet që kanë hasur në jetën e tyre para dhe gjatë trafikimit. Ata kanë shpesh dyshime nëse do të jenë të gjendje ta përballojnë vetë jetën dhe të kujdesen për veten. Një pjesë e këtij ankthi shfaqet në formën e simptomave fizike, si dhimbje koke, dhimbje stomaku dhe probleme me gjumin.

### Ndjenjat dhe sjelljet e viktimave në fazën e tranzicionit

“Suzana” filloi një punë të re dhe së fundmi mori rrogën e saj të parë. Ajo po ia del mirë me punën dhe shkon mirë me kolegët dhe punëdhënësin e saj. Ata e pëlqejnë dhe e respektojnë. Megjithatë, së fundmi, ajo ka filluar të shqetësohet se nuk do të jetë në gjendje të përballojë jetesën në apartamentin e saj ose të menaxhojë jetesën e pavarur. Ajo po bëhet gjithmonë e më shumë nervoze për të ardhmen dhe ka frikë se mund t’i ndodhë diçka e keqe. Frika dhe stresi i saj po shfaqen edhe me simptoma fizike, si dhimbje koke dhe të përziera.

Disa viktimat shprehin një përzjerje ndjenjash dhe emocionale kontradiktore që ato duhet t’i kapërcejnë dhe menaxhojnë. Për shembull, disa viktimat i kthehen pas dhe kujtojnë periudhën kur janë trafikuar si abuzive por dhe si një periudhë kur janë dashuruar. Ky është rasti kur ato kanë pasur një marrëdhënie emocionale me trafikantin.

“ U bënë disa muaj që kam filluar punë. Më pëlqen puna dhe jam e lumtur. Por ende mendoj... se çfarë do të ndodhë me mua kur njerëzit që kam denoncuar të dalin nga burgu? Dhe kur mendoj për të, më rrënoqethet mishi...(Minorene, e trafikuar për shfrytëzim seksual, e asistuar nga D&E)

Në raste të tjera, viktimat mund të ndihen të suksesshme dhe me vetëbesim në disa aspekte të jetës së tyre (për shembull, gjetja e një pune dhe performanca e mirë në mjedisin e punës), por mund të ndihen edhe nervoze dhe të pasigurta për të ardhmen (për shembull, nëse do jenë në gjendje të jetojnë e pavarur). Disa përfitues që kanë denoncuar trafikantët e tyre mund të ndihen të konfliktuar për vendimin dhe madje mund të duan të tërhiqen nga ky proces, sepse në këtë fazë ndihen më të qetë, ose ndiejnë frikë se përfshirja në procesin ligjor do t’i pengojë që të përparojnë në jetën e tyre.

Ndjenjat dhe sjelljet e viktimave në fazën e tranzicionit përfshijnë:

- ☘ Gëzim dhe shpresë (ndjekja e ëndrrave, qëllimeve)
- ☘ Frikë nga ndryshimi (ndryshime në rutinën e dikujt që përballet me situata të reja që mund të jenë të vështira për t’u menaxhuar)

- 🌸 Entuziazëm (për gjëra të reja që do të ndodhin, marrëdhënie dhe kontakte të reja)
- 🌸 Padurim për gjëra të reja
- 🌸 Rritja e vetëbesimit dhe vetëvlerësimit si rezultat i aftësive, kapaciteteve dhe përvojave të reja të jetës.
- 🌸 Konfuzion dhe shqetësim për të ardhmen, situatat e reja jetësore dhe procesi i riintegrit
- 🌸 Ekstreme në reagimet emocionale (ndarja e informacionit personal, të folurit shumë për përvojën apo situatën e vet, mbajtjen private të gjithçkaje)
- 🌸 Frikë nga dështimi, mohimi i aftësive personale, mospërparimi në arritjen e qëllimeve
- 🌸 Padurim, që çon në sjellje të pamatur dhe të pamenduar



## Asistenca dhe mbështetja në fazën e tranzicionit

Në këtë periudhë, viktimat kalojnë në më shumë pavarësi në jetën e tyre të përditshme, duke përfshirë rregullimet e tyre të jetës. Ato marrin më shumë kontroll dhe përgjegjësi mbi jetën e tyre. Asistenca në këtë periudhë përqendrohet te mbështetja e tranzicionit të tyre drejt pavarësisë dhe autonomisë.

Për shembull, viktimat e rritur duhet të mbështeten për të arritur pavarësinë ekonomike dhe vetëmjaftueshmërinë. Ato angazhohen në formim profesional, si dhe në aktivitete orientimi për tregun e punës dhe këshillohen për të gjetur vend pune të përshtatshëm. Këshillimi dhe mbështetja për të gjetur punë përfshin udhëzime për aspekte të ndryshme praktike të tregut të punës, si: mënyra e shkrimit të një CV-je, përgatitja për intervistë pune, komunikimi me kolegët dhe punëdhënësit, dhe sesi të menaxhohen sfidat në vendin e punës.

“ Ndërkohë që jetoja në qendrën rezidenciale, ndoqa një kurs për banakiere dhe shefe pasticerie. Pata mundësinë t’i praktikoj këto profesione në biznesin social të ngritur nga organizata... Më pëlqen të pjek, keku (brownie) është ëmbëlsira ime e preferuar dhe jam e zonja në përgatitjen e kapuçinos. (Grua e trafikuar për shfrytëzim seksual, e asistuar nga D&E) ”

Disa viktimat janë angazhuar në programe stazhi/praktike për të zhvilluar aftësitë e tyre profesionale ose për të avancuar aftësitë e tyre të formimit profesional përpara se të kërkojnë punësim formal. Disa të rritur ndjekin arsimin formal për të përfunduar shkollimin e tyre përpara se të ndjekin trajnime dhe mundësi ekonomike. Në disa raste, përfituesit kanë një profesion dhe madje një përvojë pune mjaft të rëndësishme, por e kanë të pamundur për të vazhduar punën në atë fushë, për shkak të lëndimeve apo sëmundjeve të shkaktuara nga trafikimi.

## Asistenca dhe mbështetja në fazën e tranzicionit

“Amiri” ka punuar më parë si punëtor ndërtimi, por nuk e bënte më këtë lloj punë për shkak të një lëndimi që pësoi kur trafikohej për punë të detyruar. Prandaj, Amiri kishte nevojë për formim profesional në një fushë të re pune dhe për mbështetje në zhvillimin e një rrjeti të ri profesional nëpërmjet të cilit mund të gjente punë. Për më tepër, pamundësia për të vazhduar punën në fushën e tij e bëri atë të ndihej keq për veten, gjë që ndikoi në mirëqenien e tij emocionale. Si i tillë ai përfitoi nga formimi profesional si dhe nga asistenca e vazhdueshme psikologjike dhe mjekësore. Ai ka marrë edhe ndihmë për aftësinë e kufizuar pasi nuk është në gjendje të punojë për shkak të plagëve të marra. Gjithashtu i është ofruar ndihmë që vajza e tij të ndjekë kopshtin dhe gruaja të gjejë punë.

Fëmijët viktime janë mbështetur për të vazhduar arsimin e tyre formal, qoftë nëpërmjet rifutjes në shkollë apo programeve ekuivalente. Ata mund të ndjekin edhe kurse shtesë që ju interesojnë, si për kompjuterin dhe gjuhët e huaja. Në varësi të moshës së fëmijëve, ata mund të marrin formim profesional për gjetjen e një pune të përshtatshme. Të rinjtë e trafikuar zakonisht mbeten pas në arsimin e tyre formal dhe mund të kenë mungesë të aftësive bazë të leximit dhe matematike, gjë që kërkon “programe arsimore specifike”. Formimi profesional, i ndërthurur me asistencë arsimore dhe ekonomike, mund t’i ndihmojë ata për të përparuar në mënyrë konstruktive në jetën e tyre.

Fëmijët viktime të trafikimit kanë nevojë edhe për aktivitete sociale dhe argëtuese në këtë periudhë për të zhvilluar interesa dhe hobi, dhe për të qenë në gjendje të ndërveprojnë në mënyrë të shëndetshme dhe pozitive me ata përreth tyre. Në këtë fazë ndodh edhe zhvillimi i aftësive të tjera jetësore, si aftësitë në komunikimin ndërpersonal, menaxhimi i kohës, marrëdhëniet shoqërore të shëndetshme, dhe teknikat e vetëmbrojtjes. Këto aktivitete ndërmerren shpesh nga mentorët që iu ofrojnë fëmijëve një marrëdhënie pozitive dhe një model gjatë riintegritimit të tyre.

### **Asistenca dhe mbështetja në fazën e tranzicionit**

“Davide” është 18 vjeç. Ai u trafikua për kryerjen e aktiviteteve kriminale, duke përfshirë vjedhje dhe shpërndarje droge. Ai u trafikua që në moshë të vogël dhe si rrjedhim nuk e kreu shkollën e mesme. Pasi u shkëput nga situata e tij e trafikimit, ai u mbështet nga një organizatë riintegruese. Ai ndoqi një kurs profesional gatimi, dhe më pas punoi si praktikant në një restorant të njohur të qytetit. Më pas, ai u mbështet për të gjetur një punë dhe tani punon si kuzhinier në një restorant të vogël familjar. Davide punon fort dhe e ka treguar veten si një profesionist, të besueshëm dhe korrekt, dhe e ka mbajtur punën e tij për disa kohë. Tani ai është në gjendje të paguajë faturat dhe të mbështesë veten. Ai bën një jetë të thjeshtë, pa probleme apo vështirësi.

Gjatë fazës së tranzicionit, përfituesit përgatiten për jetesë të pavarur, duke përfshirë krijimin e vetëbesimit, përmirësimin e marrëdhënieve familjare dhe ndërpersonale, dhe aftësitë e prindërimit për viktimat me fëmijë. Kjo përfshin edhe rritjen e aftësive praktike për jeten, si vendimmarrja dhe menaxhimi i kohës dhe burimeve, buxhetin familjar, promovimin arsimor dhe shëndetësor, planet për të ardhmen dhe përgatitjen për jetesë të pavarur. Disa përfitues vijnë nga familje ku prindërit e tyre nuk i kanë këto aftësi praktike. Disa kanë jetuar në rrugë kur janë trafikuar dhe kanë mësuar vetëm se si të jetojnë dhe të mbijetojnë për momentin, pa menduar apo planifikuar për të nesërmen.

Pas përfundimit të formimit profesional dhe mbajtjes së punës për pak kohë, përfituesit largohen nga strehëza në apartamente ku do t’iu ofrohet mbrojtje dhe subvencion për një periudhë të përkohshme, derisa të jenë në gjendje të marrin përsipër përgjegjësinë për të gjitha kostot e jetesës. Të tjerët jetojnë në apartamente që i ndajnë me miqtë e tyre ose jetojnë të pavarur. Në përgjithësi, kjo ndodh pasi viktime ka përfunduar një nivel arsimit ose formimi, dhe mund të ketë punuar për disa kohë. Viktimat me fëmijë punojnë shpesh me orare jo të rregullta ose me turne, që do të thotë se kanë nevojë për shërbime të kujdesit për fëmijën (për shembull, çerdhe, programe të kujdesit ditor, kopësht), si dhe programe pas shkolle dhe alternativa mundësie kujdesi për femije ndërkohë që ato janë në punë.

Është shumë e vështirë për t’u vendosur në një vend të ri, ku ata nuk njohin askënd si dhe është e vështirë për të menaxhuar kostot e tyre të jetesës. Disa viktime të trafikimit kthehen për të jetuar me familjet e tyre në shtëpi dhe komunitetet e origjinës, ku ato asistohen për të gjetur punë. Disa përfitues kthehen në komunitetet e tyre të origjinës për të qenë pranë familjeve të tyre, por nuk jetojnë me to. Në të dyja rastet mbështetja nga familjet e tyre, e bën më të lehtë riintegrimin dhe ato ndihen si në shtëpi.



Ndërmjetësimi me familjen është kritike dhe e rëndësishme në këtë fazë, pasi merren vendime nëse dhe kur është e sigurt dhe e këshillueshme që përfituesit të kthehen të jetojnë me familjet e tyre, ose të kontaktojnë me to. Disa përfitues vijnë nga mjedise familjare të dhunshme (me abuzim fëmijësh, dhunë në familje) ose jetojnë me familjarë me sjellje të pashëndetshme (për shembull, abuzimi me drogën ose alkoolin, kumari). Në këto raste, është e nevojshme të vlerësohet nëse ky është një mjedis që mund të ndryshohet dhe, nëse po, në cilën fazë është e sigurt që përfituesi të kthehet dhe të riintegrohet.

Gjatë kësaj faze të tranzicionit, disa fëmijë kthehen të jetojnë me familjet e tyre. Kjo bëhet vetëm pas kryerjes së një vlerësimi nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, dhe pasi mjedisi në shtëpi përcaktohet si i sigurt për kthimin dhe riintegrimin. Kjo kërkon të kuptuarit e dinamikave të familjes së përfshirë dhe mënyrat se si fëmija ose i riu (dhe familja e tij) mund të mbështetet më mirë.

Për fëmijët që e kanë të pamundur kthimin në shtëpi për të jetuar me familjet e tyre, alternativat janë mjaft të kufizuara. Disa fëmijë mund të vendosen në familje kujdestare, megjithëse ky sistem mbetet i pazhvilluar në Shqipëri me vetëm mundësi të kufizuara vendosjeje. Fëmijë të tjerë mund të sistemohen në mjedise të kujdesit alternativ (për shembull, shtëpi-familje me një numër të vogël fëmijësh dhe të rinjsh), edhe pse këto shtëpi janë në numër të kufizuar. Disa fëmijë vendosen të akomodohen edhe me të afërmit (për shembull, te familjarë apo të afërm mbështetës, si daja/xhaxhai, halla/tezja, motra, vëllai, etj.), me vullnet për t'u kujdesur për fëmijën në familjet e tyre.

Gjatë fazës së tranzicionit, përfituesit vazhdojnë të marrin mbështetje të vazhdueshme për të plotësuar nevojat e tyre për ndihmë, por me përshtatje sipas specifikave të tyre të kësaj faze dhe rikuperimit individual të viktimës. Për shembull, kur periudha e krizës karakterizohet nga nevoja mjekësore urgjente për të trajtuar pasojat e trafikimit (si lëndimet dhe sëmundjet), asistencë në këtë fazë fokusohet më shumë te shëndeti dhe mirëqenia e përgjithshme, dhe te kontrollet e rregullta shëndetësore bazë. Po ashtu, këshillimi në këtë fazë fokusohet te zhvillimi i aftësive praktike (aftësitë e komunikimit, vendimmarrja, menaxhimi i kohës, menaxhimi i të ardhurave), krijimi i marrëdhënieve ndërpersonale konstruktive (me familjen, punëdhënësit, kolegët e punës) dhe te zhvillimi i aftësive për të mbajtur vendin e punës.

Këshillimi është gjithashtu i orientuar për të përfshirë ndërmjetësimin me familjen, për të ndihmuar viktimat të ndërtojnë ose përmirësojnë marrëdhëniet me familjen e tyre ose të krijojnë forma të tjera mbështetjeje, nga të afërm ose miq të tjerë. Kjo është gjithashtu e rëndësishme për anëtarët e familjes që të kuptojnë se çfarë ka ndodhur në jetën e viktimës si dhe rolin e tyre në procesin e riintegritimit dhe mbështetjen që ata mund të ofrojnë.

Në këtë fazë, asistencë duhet t'u ofrohet edhe pjesëtarëve të familjes së viktimave. Kur viktimat kthehen për të jetuar me familjen e tyre, pjesëtarët e familjes duhet të mbështeten që të jenë në gjendje të mbështesin rikuperimin dhe riintegrimin e viktimave. Ndër të tjera, kjo përfshin mbështetjen e

“**Thellë thellë ai është një person i mirë.... E di se ai nuk do që të na lëndojë. Por megjithatë, ai dhe dhuna e tij ishte arsyeja se përse u largova nga shtëpia. (Djalë 14-vjeçar, i trafikuar për aktivitete kriminale, i asistuar nga D&E)**”

“**Babai im ishte i dhunshëm pa arsye. Në fillim ai godiste nënën... më pas edhe mua. E urreja babanë sepse shkaktonte stres për të gjithë familjen. Kur ishte esëll ai na kërkonte falje, qante dhe na kërkonte të ktheheshim në shtëpi, ose në të kundërt do të vriste veten sepse nuk mund të jetonte pa ne. Doja ta ndihmoja. Në fakt, ai është babai im, unë dua të kujdesem për të. (Vajzë 14-vjeçare, e trafikuar për shfrytëzim seksual, e asistuar nga D&E)**”

pjesëtarëve të familjes së viktimës (prindër, bashkëshortë, motra/vëllezër) për të gjetur punë, për të ndjekur kurse profesionale, adresuar probleme shëndetësore, për të ofruar mbështetje dhe këshillim psikologjik, adresuar çështje ligjore (si divorci, dhuna në familje), për të ngritur dhe menaxhuar biznese të vogla. Fëmijët viktimë të trafikimit kërkojnë asistencë në ndjekjen e shkollës, duke përfshirë mbështetje për rifutjen në shkollë, materiale shkollore dhe ndihmë në përgatitjen e mësimëve. Shpesh, kërkohet certifikatë lindjeje dhe dokumente identifikimi për të pasur akses në shërbime të ndryshme.

Po gjatë fazës së tranzicionit, viktimat informohen për shërbime dhe mbështetje në komunitetin e tyre (ose në komunitetin e familjes së tyre ose në komunitetin ku ata integrohen), të ofruara nga OJF dhe institucione shtetërore. Ata pajisen me një hartë të shërbimeve komunitare, të cilat mund t'i aksesojnë sipas nevojës. Menaxherët e rastit i ofrojnë viktimave informacion mbi shërbimet ekzistuese në komunitetin e tyre, duke përfshirë mënyrën se si t'iu drejtohen këtyre organizatave dhe institucioneve për të marrë shërbime. Ato mund të shoqërohen nga menaxherët e tyre të rastit për të mësuar se si të drejtohen dhe t'i kërkojnë këto shërbime, në mënyrë që ta bëjnë këtë më vonë. Viktimat gjithashtu mbështeten dhe inkurajohen të jenë të angazhuar dhe motivuar në procesin e tyre të riintegrit.

Menaxheri i rastit monitoron përfituesit e fazës së dytë të riintegrit, të paktën një herë në javë, qoftë nëpërmjet vizitave direkte apo telefonatave. Ndjekja sistematike afatgjatë është një pjesë e rëndësishme e punës së riintegrit, pasi e lejon stafin të identifikojë dhe adresojë nevojat e përfituesve kur ato lindin, si dhe të mbështesë përfituesit në kapërcimin e vështirësive të hasura gjatë procesit të riintegrit. Po ashtu, është e rëndësishme që përfituesit të pajisen me informacion për të aksesuar shërbime dhe mbështetje në komunitetin ku jetojnë. Raporti i rregullt i progresit dhe vlerësimet e vazhdueshme kryhen nga menaxheri i rastit, në konsultim me viktimën, për të identifikuar arritjet dhe pikat e forta të secilës viktimë, dhe prioritetet për shërbimet aktuale ose të reja në nevojë për mbështetje. Ka gjithashtu mundësi që përfituesi të shkruajë çdo ankesë apo problematikë që ka lidhur me planin e riintegrit ose ofrimin e shërbimeve.<sup>17</sup>

Mbështetja vazhdon të mbikëqyret nga menaxheri i rastit, me mbështetjen e EMD-ve. Në fazën e tranzicionit, për të mbështetur përpjekjet për riintegrim përfshihen profesionistë të tjerë. Këtu përfshihen:



**Stafi arsimor** (për shembull, mësues, psikologë shkolle, drejtorë dhe administratorë shkolle) për të mbështetur rifutjen në sistemin shkollor, aksesuar programe arsimore alternative, ofruar materiale shkollore, aksesuar ndihmë në përgatitjen e mësimëve dhe mbështetje pas shkolle



**Stafi mjekësor** (për shembull, mjek familjeje, administratorë mjekësorë, mjekë të specializuara, si pediatër dhe psikiatër) për të aksesuar shërbimet shëndetësore, duke përfshirë shërbime të specializuara, qendra komunitare të shëndetit mendor në rastin e problemeve të shëndetit mendor.

---

<sup>17</sup> Është e rëndësishme që të ekzistojnë mekanizma dhe procedura, në mënyrë që përfituesit të kenë mundësi të shprehin shqetësimet dhe ankesat e tyre. Për udhëzime mbi qasje të ndryshme, ju lutemi shihni: Të Ndryshëm & Të Barabartë (2020) *Manuali i menaxhimit të rastit për viktimat e trafikimit në Shqipëri*. Tiranë, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë; Surtees, R. (2010) *Monitorimi i programeve të ri/integritit kundër trafikimit. Manual*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni i Mbretit Baudouin.



**Profesionistët e punësimit dhe fuqizimit ekonomik** (për shembull, stafi i zyrës së punës, administratorë, stafi i qendrave të formimit profesional) për të aksesuar formimin profesional, mundësitë për punësim dhe programet e punësimit.



**Administratorët publikë** (për shembull në bashki, agjenci ose zyra të ndryshme shtetërore) që mundësojnë shërbime si regjistrimin e të posalindurve, aksesin në dokumente identifikuese dhe në shërbime shtetërore si programe strehimi të subvencionuara, kujdes për fëmijët dhe regjistrimin e fëmijëve në çerdhe dhe kopsht, shërbime shëndetësore dhe ndihmë ekonomike.



**Profesionistët ligjorë** (për shembull avokatët, asistentët ligjorë, asistentët paraligjorë) që ofrojnë mbështetje dhe përfaqësim për viktimat apo dëshmitarët në procese gjyqësore penale e civile (për shembull, çështje divorci, kujdestari e fëmijës, të drejtat e pronës, mbështetje financiare dhe mbështetje për fëmijën), akses në lejet e qëndrimit për viktimat e huaja, informacione për përfitimet shoqërore dhe të drejtat (për shembull, programet e strehimit, strehim i subvencionuar, akses në dokumente), dhe aksesin në mbrojtje fizike si viktimitë trafikimi.



**Punonjësi social** (për shembull, punonjësit socialë shtetërorë dhe asistentët socialë) që bëjnë të mundur aksesin në shërbime dhe përfitime sociale, si dhe në të drejtat si viktimitë trafikimi.



**Stafi i qendrave komunitare dhe rinore** (për shembull, mësuesit, edukatorët, punonjësit socialë) për të mbështetur aksesin në aktivitete të ndryshme sociale për to dhe fëmijët e tyre.

Faza e tranzicionit karakterizohet nga disa momente kryesore. Megjithatë kjo ndryshon nga njëri person te tjetri, disa etapa të zakonshme përfshijnë:



Pajisjen me informacion mbi mbështetjen dhe shërbimet e disponueshme në komunitet (mbështetje specifike në lidhje me trafikimin dhe shërbime shoqërore në përgjithësi, nga institucione shtetërore dhe OJF)



Rritja e aftësive për jetën (përfshirë ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme, aftësitë e komunikimit, aftësitë e prindërimit, menaxhimin e kohës dhe parave, gatimin dhe pastrimin)



Gjetjen e strehimit të qëndrueshëm dhe të perballueshëm



Përfundimin e formimit profesional që lidhet me mundësitë dhe aspiratat për punë



Gjetjen dhe mbajtjen e punës dhe krijimin e marrëdhënieve konstruktive në punë dhe të sjelljeve profesionale



Frekuentimin e shkollës dhe diplomimin



Rritjen e ndjenjës së autonomisë



Motivimin dhe angazhimin në procesin e riintegrit



Rritjen personale, duke përfshirë rritjen dhe qëndrueshmërinë emocionale

## Çështje dhe konsiderata të veçanta në ndihmën e fëmijëve të trafikuar në fazën e tranzicionit

- **Vendime për zgjidhje të qëndrueshme:** Në fazën e tranzicionit, do të merren vendime nëse fëmijët mund të kthehen në shtëpi në familjen e tyre apo nëse duhet të shqyrtohen dhe ndiqen zgjidhje alternative. Shqetësim madhor përbën fakti se cilat janë alternativat e disponueshme në rast se kthimi i një fëmije për të jetuar me familjen e tij nuk është i sigurt.
- **Pjesëmarrjen në vendimmarrje:** Përfshirja direkte e viktimave në nisma që prekin direkt jetën e tyre ose të bashkëmoshatarëve është shumë e rëndësishme për të kuptuar nevojat e tyre, për të gjetur alternativa të reja dhe për të ndarë idetë.
- **Rritjen e pavarësisë dhe autonomisë:** Puna me fëmijët në këtë fazë duhet të nxisë rritjen e pavarësisë dhe autonomisë, si një aftësi kyçe në riintegrimin dhe përfshirjen sociale. Fëmijët krijojnë ndjenjën e tyre për veten në këtë fazë dhe zhvillojnë një ndjenjë përgjegjësie. Ata mund të mbështeten për të aksesuar vetë shërbimet sociale dhe gjithashtu të marrin përsipër detyra të tjera që më parë nuk ishin në gjendje t'i kryenin në mënyrë të pavarur.
- **Rikuperimin dhe rivendosjen e lidhjeve të shëndetshme shoqërore dhe mbështetjen sociale:** Vendosja e marrëdhënieve ndërpersonale me te tjerët është e rëndësishme për fëmijët. Kjo përfshin familjen, bashkëmoshatarët gjithashtu si dhe personat në rrethin e gjerë shoqëror.

### Konsiderata të veçanta për fëmijët viktime të trafikimit në fazën e tranzicionit

“Dea” u trafikua brenda vendit për shfrytëzim seksual kur ajo ishte fëmijë, vetëm 14 vjeç. Kur shpëtoi nga situata e saj e trafikimit, ajo u akomodua fillimisht në një strehëz për gjashtë muaj, për ta ndihmuar që të kapërcente traumën dhe të rikuperohej fizikisht. Si fëmijë ajo kishte nevojë për një mbështetje dhe ndihmë të madhe për rikuperimin dhe riintegrimin e saj, veçanërisht pasi shkollimi i saj ishte ndërprerë si pasojë e trafikimit. Ajo kishte nevojë të vazhdonte dhe përfundonte arsimin formal dhe të ndiqte programe të tjera arsimore (kurse kompjuteri dhe të gjuhës angleze) për të përmbushur kërkesat e shkollës.

Përvoja e saj e trafikimit kishte ndikuar gjithashtu në aftësinë e saj për të zhvilluar marrëdhënie shëndetësore, për të krijuar një rrjet social të sigurt dhe për të zhvilluar aftësitë e komunikimit ndërpersonal. Mbështetje u ofrua për të rivendosur marrëdhëniet me familjen e saj dhe gjatë kësaj kohe, marrëdhënia e saj me prindërit u përmirësua ndjeshëm. Dea vendosi të kthehej në shtëpi për të jetuar me familjen në këtë fazë tranzicioni dhe familja e saj ishte e lumtur ta pranonte. Ajo vazhdoi programin e saj të riintegrimin edhe gjatë qëndrimit në shtëpi dhe iu dha ndihmë Deas dhe gjithë familjes.

## Çështjet kryesore në fazën e tranzicionit Udhëzime për profesionistët

Faza tranzitore është periudhë e rëndësishme dhe themelore për riintegrimin afatgjatë të përfituesit. Profesionistët luajnë një rol kritik në mbështetjen e viktimave në këtë fazë, duke krijuar edhe hapësirë dhe mundësi për ata që të ndërmarrin nisma në riintegrimin e tyre. Më poshtë, paraqiten udhëzime dhe orientime kyç për profesionistët për t'i mbështetur përfituesit gjatë fazës së periudhës tranzitore:

- Jini mbështetës dhe të duruar në të gjitha ndërveprimet me përfituesin, duke pranuar se ndjenjat dhe reagimet negative janë pjesë e natyrshme e rikuperimit të tyre dhe nuk janë pasqyrim i juaji ose i punës suaj.** Faza e tranzicionit përfshin sukseset dhe frustrimet, dhe përfituesit do t'i shprehin këto emocione dhe reagime në stadi të ndryshme të kësaj faze.
- Nxiteni përfituesin të ndjekë planin e tij riintegrimit, të bëjë hapa përpara, të ndërmarrë hapa të vegjël por të qëndrueshëm drejt suksesit të riintegrimit të tij.** Punoni me viktimat për të shqyrtuar dhe rishikuar planin, sipas nevojës dhe si përgjigje ndaj të gjitha ngjarjeve jetësore. Sigurohuni që plani i riintegrimit të jetë realist dhe i arritshëm, me qëllime të identifikuar në intervale kohore specifike. Sigurohuni që asistenca dhe shërbimet të përshtaten me nevojat specifike të përfituesit.
- Sigurohuni që përfituesi të përfshihet dhe të jetë në qendër të të gjitha vendimeve për riintegrimin e tij.** Kjo përfshin fëmijët që duhet të mbahen të informuar dhe angazhuar në vendimmarrje mbi çfarë i plotëson më mirë nevojat dhe interesat e tyre.
- Punoni ngushtë me kolegët tuaj të ekipit multidisiplinar në fazën e tranzicionit dhe në identifikimin e asistencës dhe mbështetjes.** Bëni kërkime për organizata dhe institucione të ndryshme që ofrojnë shërbime të nevojshme për përfituesin në fazën e tranzicionit. Bashkëpunoni me institucione dhe organizata të ndryshme për të siguruar që përfituesi të ketë akses në të gjitha shërbimet dhe mbështetjen e nevojshme në fazën e tranzicionit.
- Ofrojini përfituesit informacion me shkrim dhe me gojë mbi asistencën në një mënyrë që është i kuptueshëm, i aksesueshëm dhe i përshtatshëm për moshën.** Sigurohuni që përfituesi ka informacion mbi shërbime afatgjata gjithëpërfshirëse për të mbështetur riintegrimin e tij/saj. Kjo mund të jetë mbështetje specifike si viktimitë trafikimi ose shërbime më të përgjithshme, të ofruara nga shteti ose OJF.
- Komunikoni në çdo kohë hapur me përfituesin, në mënyrë që të ndihet rehat për të komunikuar me ju në çdo moment dhe për të bërë pyetje lidhur me nevojat e tij, dhe se si mund të plotësohen ato.** Komunikoni rregullisht me viktimat lidhur me progresin e planit të tyre të riintegrimit, dhe punoni bashkërisht për të bërë përshtatje, duke përfshirë aksesimin e shërbimeve shtesë.

**Kërkoni dhe pranoni mbështetje dhe udhëzime kur janë të nevojshme.** Komunikoni dhe punoni me supervizorin tuaj për çdo problem dhe shqetësim që hasni. Kërkoni këshilla, udhëzime dhe mbështetje edhe nga kolegët tuaj.

**Kushtojini vëmendje plotësimi të nevojave që janë specifike për këtë fazë tranzicioni.** Për shëmbull, duke përfshirë zhvillimin e aftësive për jetën, nxitjen e zakoneve psikosociale të shëndetshme për jetesë të pavarur, aksesim në arsimin bazë së bashku me programe të formimit profesional dhe fuqizimit ekonomik.

**Përshtatini shërbimet dhe mbështetjen me mjedisin përkatës të fazës së tranzicionit.** Për shëmbull, ata që bëjnë jetë gjysëm të pavarur, ata që janë kthyer në shtëpi dhe ata që riintegrohen në një komunitet të ri.

**Njihni dhe merrni në konsideratë rolin kyç të luajtur nga rrjeti shoqëror i përfituesit në rikuperimin dhe riintegrimin e tij, duke përfshirë një rrjet sigurie në rastet e krizës.** Punoni me përfituesin për të zhvilluar dhe përmirësuar rrjetin e tyre shoqëror në këtë fazë.

**Monitoroni rregullisht progresin e përfituesit dhe jini reflektues dhe fleksibël në rishikimin e progresit të tij.** Bëjeni këtë vlerësim në koordinim dhe komunikim të ngushtë me përfituesin, dhe merrni në konsideratë pikëpamjet e tyre për hapat e radhës.

**Pranoni dhe merrni në konsideratë se kjo fazë do të jetë mjaft kërkuese për disa viktima, dhe në rastin e tyre mund të nevojitet më shumë kujdes dhe vëmendje.** Të jini fleksibël dhe të hapur ndaj nevojës për mbështetje dhe vëmendje më të madhe.

**Kini parasysh se puna me fëmijët e trafikuar në fazën e tranzicionit ka sfida dhe pengesa specifike që mund të krijojnë vështirësi për ju si profesionist.** Në këtë fazë, punoni ngushtë me punonjësit e mbrojtjes së fëmijës.

**Sigurohuni që të gjitha vendimet në rastin e një fëmije të trafikuar të jenë në interesin më të lartë të fëmijës.** Përfshijeni fëmijën në këtë vlerësim të mundësive, alternativave dhe masave të ndërmarra, dhe diskutoni paraprakisht çdo vendim me fëmijën. Sigurohuni që të gjitha masat, veprimet të merren me pëlqimin e prindit (ose kujdestarit ligjor), dhe e mira do të ishte edhe me pëlqimin e fëmijës.

**Sigurohuni që qasja juaj në punën me viktimat të jetë me në qendër viktimën, me ndjeshmëri gjinore, miqësore me fëmijën, e përshtatshme në aspektin kulturor dhe e informuar për traumat.** Kërkoni udhëzime dhe mbështetje nga supervizoret dhe kolegët për t'u siguruar se se kjo është mënyra e duhur. Jini të hapur ndaj sugjerimeve se si mund të zbatohen këto qasje në praktikë.

## Faza #3. Riintegrimi dhe përfshirja (nga 13 në 36 muaj).



### Rreth fazës së riintegritit dhe përfshirjes

Kjo fazë fillon kur viktimat është gati të jetojnë një jetë të pavarur. Fokusi është te nxitja e fuqizimit dhe vetëbesimit të viktimave, dhe mbështetja e tranzicionit të tyre drejt pavarësisë së plotë, duke përfshirë aftësinë për të mbështetur veten për të mbajtur një standard të denjë jetese, dhe për të vepruar në mënyrë optimale në shoqëri. Ata kanë plane konkrete dhe realiste për të ardhmen e tyre dhe për të punuar drejt arritjes së këtyre qëllimeve në këtë periudhë, dhe po punojnë për këto qëllime.

Në këtë fazë, përfituesit kanë filluar të jetojnë një “jetë normale” dhe gjatë kohëzgjatjes së kësaj faze ata bëhen gjithmonë e më shumë të pavarur, autonomë dhe me vetëbesim. Në shumë raste, ata janë fizikisht dhe psikologjikisht mirë dhe kanë akses në shërbime që ju nevojiten për të ruajtur mirëqenien e tyre. Ata jetojnë në apartamente me qira ose kthehen në shtëpi për të jetuar me familjet. Në disa raste, përfituesit krijojnë një marrëdhënie personale të shëndetshme dhe të qëndrueshme, martohen dhe kanë fëmijë.

Ata zakonisht nuk kanë probleme të sigurisë të lidhura me situatën e trafikimit, por edhe nëse kanë ndonjë problem me sigurinë, ata dinë se çfarë të bëjnë dhe ku të drejtohen e shkojnë (ato kanë listën e kontakteve për emergjencë dhe dinë se si të komunikojnë me autoritetet përkatëse). Ata kanë informacion për shërbimet e disponueshme në komunitetin e tyre dhe se si t’iu drejtohen vetë këtyre shërbimeve. Me ngritjen e çështjeve dhe nevojave, ata janë në gjendje të gjejnë mënyra për t’i adresuar ato, duke përfshirë marrjen e shërbimeve dhe asistencës, sipas nevojës.

Dhe ndërkohë që jetojnë të pavarur dhe në përgjithësi në gjendje për ta përballuar vetë jetesën, ata përballen herë pas here me probleme të sigurisë, ato ligjore, probleme psikosociale dhe probleme shëndetësore).

### Në fazën e riintegritit dhe përfshirjes

“Vera” ka pasur gjithmonë vetëvlerësim të ulët. Në kohën që ishte asistuar në strehëz, ajo ndiqte një kurs rrobaqepësie, dhe punonjësja e saj punonte me të për rritjen e vetëbesimit dhe fuqizimit të saj. Sapo përfundoi trajnimin, ajo punoi në firma të ndryshme rrobaqepësie për të fituar përvojë. Me kalimin e kohës, u bë gjithmonë e më shumë e zonja në aftësitë e saj dhe kishte më shumë vetëbesim. Tashmë ajo drejton një biznes të vogël, i cili i mundëson të fitojë para për të mbështetur veten dhe vajzën. Ajo ka ndryshuar shumë gjatë periudhës së riintegritit të saj. Të pasurit e një biznesi të suksesshëm i ka dhënë asaj shumë vetëbesim, si dhe gëzim në punën e saj si rrobaqepëse.

Në këtë periudhë, përfitueset gjejnë punë ose hapin biznese, apo aktivitete që gjenerojnë të ardhura. Fillimisht mund të kenë vështirësi për ta mbajtur punën dhe madje mund të ndryshojnë punë disa herë gjatë kësaj periudhe. Por, me kalimin e kohës në këtë fazë, zakonisht gjejnë punë që e mbajnë për një periudhë afatgjatë. Në këtë periudhë, fitojnë një shkallë të lartë pavarësie financiare dhe janë në gjendje të marrin përgjegjësi të plotë për kostot e jetesës. Madje edhe nëse kanë një punë të qëndrueshme, ata vazhdojnë të investojnë për veten dhe të rrisin aftësitë e tyre profesionale nëpërmjet kurseve profesionale, për të pasur mundësi më të mëdha në tregun e punës. Në rastin e fëmijëve, zakonisht kjo fazë përfshin vazhdimin dhe shpesh përfundimin e arsimit të tyre formal.

Gjate kësaj faze, viktimat zhvillojnë dhe ruajnë ndërveprime shoqërore dhe marrëdhënie ndërpersonale të shëndetshme, sidomos marrëdhëniet familjare. Shumë viktimat vijnë nga mjediset familjare të ndërlikuara dhe madje jofunksionale, dhe janë përballur me problematika që variojnë nga aftësitë e dobëta të komunikimit dhe prindërimit të neglizhencës dhe dhunës. Viktimat të tjera vijnë nga familje që kanë vështirësi për ta përballuar pasojat e trafikimit të personi i dashur i tyre dhe të jeta dhe

marrëdhëniet e tyre familjare. Në këtë rast, familjet përfshihen në procesin e riintegrit dhe bëhen më mbështetës dhe bashkëpunues. Është bërë shumë punë për të mbështetur dhe nxitur mjediset familjare të shëndetshme dhe të sigurta. Shumë viktime kthehen në shtëpi për të jetuar me familjet e tyre në këtë fazë, ose kane kontakte të rregullta me ta.

Në përgjithësi, kjo fazë zgjat nga një në tre vjet, por mund të jetë edhe më e gjatë, në varësi të situatës personale, familjare dhe komunitare të individit. Disa përfitues duhet të asistohen në këtë program për një periudhë më të gjatë krahasuar me të tjerat. Këto përfshijnë:

- fëmijët dhe të rinjtë e trafikuar,
- viktimat që kanë denoncuar trafikantët e tyre dhe që përballen me probleme të sigurisë,
- viktimat që janë përfshirë në program të shoqëruar me fëmijët e tyre,
- viktimat me aftësi të kufizuara,
- viktimat me probleme të shëndetit mendor.

Kjo fazë fillon zakonisht pas një viti nga ndërhyrja gjatë krizës dhe tranzicioni, por disa viktime mund të jenë në gjendje të fillojnë të punojnë për t'u riintegruar më herët.



### Ndjenjat dhe sjelljet e viktimës në fazën e riintegrit dhe përfshirjes

Faza e riintegrit dhe përfshirjes kategorizohet nga ndjenja të zhvillimit, rritjes dhe mirëqenies së vazhdueshme. Viktimat zhvillojnë dhe përmirësojnë aftësitë për jetën në tërësi. Përfituesit fillojnë të realizojnë potencialin e tyre dhe të përmirësojnë sjelljen dhe reagimet e tyre me kalimin e kohës. Ato kane qëllime, vendosin synime të reja dhe arrijnë objektivat e tyre. Në përgjithësi, viktimat përfshihen mirëqenie fizike dhe psikologjike, si dhe rritje të vetëbesimit dhe vetëvlerësimit.

### Ndjenjat dhe sjelljet e viktimës në fazën e riintegrit dhe përfshirjes

“Altina” thotë se është shumë e emocionuar për t'u zhvendosur dhe jetuar vetëm. Të qenit pjesë e programit i jep asaj ndjenja rehatie dhe mbështetjeje. Ndonjëherë, ajo ka dyshime te vetja (se si do t'ia dalë me gatimin, me kujdesin për shtëpinë e vetme, pagesën e faturave dhe përgjegjësi të tjera), por e di se ka një punë të mirë me një rrogë të mirë që i mundëson të mbulojë shpenzimet e saj të jetesës dhe të jetojë një jetë të mirë. Ajo ka edhe shoqeri të mirë.

“Iliri” është i martuar i lumtur, me fëmijë. Ai migroi për të mbështetur familjen e tij por përfundoi i trafikuar për punë të detyruar. Ai ishte i lumtur të kthehej në shtëpi për të jetuar me familjen e tij, por ishte thellësisht i trishtuar që lëndimet e pësuar kur ishte i trafikuar e pengonin që të mbante në krahë vajzën e tij të vogël.

“Albana” është 22 vjeçe dhe jeton me familjen e saj. Ajo punon si asistente në një zyrë finance dhe studion financë në universitet. Ajo thotë se lodhet shumë gjatë ditës, por ndihet e kënaqur dhe e lumtur që ia del të fitojë të ardhura që e mbështetin atë dhe e ndihmojnë familjen me disa shpenzime. Kjo ka rritur vetëbesimin e saj dhe e motivon çdo ditë.

Përfitueset mësojnë edhe për shërbimet publike të disponueshme dhe se si mund të përfitojnë nga sistemi shtetëror. Kjo përfshin edhe vetëbesimin për të qenë në gjendje për të komunikuar me ofruesit e shërbimit, kur kërkojnë këto shërbime dhe mbështetje. Në përgjithësi, përfituesit punojnë në këtë periudhë dhe krijojnë përvojë pune të vlefshme. Ato trajtohen profesionalisht dhe kanë përvojë pune. Kanë njohuri se si të gjejnë një punë të re nëse e kanë të nevojshme. Po ashtu, ato kanë një rrjet shoqëror dhe kane fituar vetëbesim në marrëdhëniet e tyre shoqërore.



Në të njëjtën kohë, viktimat mund të ndiejnë një nivel të caktuar lodhjeje dhe madje frustrimi, teksa përballen gjithnjë e më shumë me sfidat e jetës të vetëm, duke përfshirë pengesa dhe kriza të ndryshme me kalimin e kohës. Në disa raste, ata mund të përjetojnë stigmë dhe diskriminim nga fqinjët dhe komuniteti kur kthehen në shtëpi. Viktima që kanë denoncuar trafikantët e tyre ndihen ndonjëherë të pasigurtë kur mendojnë për lirin e trafikantëve të tyre nga burgu dhe mund të dinë se ku jetojnë viktimat dhe familjet e tyre. Viktimat duhet të përballen edhe me sfidat e jetës së përditshme (për shembull, me të ardhurat e ulëta ose punën e pakënaqshme), si dhe me krizat jetësore, si fëmijë ose prindër që janë sëmurë ose që kanë nevojë për kujdes dhe burime shtesë.

Ndjenjat dhe sjelljet e zakonshme në fazën e riintegrit dhe përfshirjes përfshijnë:

- 🌀 Ndjenja të mirëqenies (për të jetuar në mënyrë të pavarur dhe për të marrë vetë vendimet)
- 🌀 Kënaqësi në eksplorimin, zbulimin dhe të mësuarit e gjërave të reja
- 🌀 Kënaqësi e të qenit në gjendje për përmbushjen e nevojave të veta
- 🌀 Të qenit në gjendje për të shfaqur empati ndaj të tjerëve në situata të ngjashme
- 🌀 Emocion (për fillimin e një jete të re, mbështetja te vetvetja)
- 🌀 Mirënjohje (për individët që i mbështetin në kohë të vështira)
- 🌀 Konfuzion, frustrim dhe dyshime mbi menaxhimin e të ardhmes dhe ndryshimeve që mund të dalin
- 🌀 Vetëbesim në përmirësimin dhe përdorimin e aftësive të veta
- 🌀 Besim (të besuarit te vetja, te të tjerët, në shoqëri dhe strukturat shoqërore)
- 🌀 Krenari për suksesin e vet dhe për të qenit në gjendje për të shërbyer si model për përfituesit e tjerë në fazat e hershme të riintegrit



### **Asistenca dhe mbështetja në fazën e riintegrit dhe përfshirjes**

Asistenca dhe mbështetja në këtë fazë të procesit të riintegrit fokusohet te krijimi dhe ruajtja e vetëmjaftueshmërisë, pavarësisë dhe mirëqenies së përgjithshme të viktimave. Asistenca në këtë periudhë përqendrohet te nxitja e suksesit të tyre lidhur me pavarësinë dhe autonominë. Kjo mund të përfshijë kthimin e viktimës për të jetuar në familjen e tij dhe komunitetin e origjinës, ose integrimin në një komunitet të ri, apo madje në një shtet të ri.

Mbështetja në këtë fazë përfshin asistencën për riintegrim për të plotësuar çdo nevojë të vazhdueshme, si dhe të familjes dhe komunitetit ku përfituesi ka vendosur të riintegrohet. Asistenca për viktimën fokusohet te vetëmjaftueshmëria, që zakonisht nënkupton:

- ✓ Mundësi për fuqizim ekonomik (mbështetje në gjetjen dhe mbajtjen e punës, ose hapjen dhe menaxhimin e një biznesi të vogël që siguron jetesë të pavarur. Në përgjithësi, formimi profesional përfundon në fazën e tranzicionit, por në disa raste përfituesit mund të kërkojnë formim të vazhdueshëm ose të mëtejshëm në këtë periudhë).
- ✓ Mbështetje psikologjike (mbështetje në përgatitjen për jetesë të pavarur dhe kapërcimin e çdo vështirësie të hasur gjatë kësaj faze të procesit të riintegrit, dhe rritjen e motivimit të tyre personal në jetën e përditshme).
- ✓ Mbështetje arsimore (mbështetje për ata që nuk kanë ndjekur një nivel të kënaqshëm arsimor, gjë që kufizon mundësitë për të siguruar dhe ruajtur një vend pune të denjë).
- ✓ Informacion rreth shërbimeve (ritje e njohurive për burimet dhe shërbimet e ndryshme të disponueshme në komunitetin ku rastet do të riintegrohen duke përfshirë informacionin për kontakte dhe një hartë shërbimesh, udhëzime për kontaktimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve me institucionet mbështetëse në komunitetin ku riintegrohen).
- ✓ Mbështetje ligjore (mbështetje gjatë proceseve gjyqësore civile mbi të drejtën për kompensim, si dhe çdo çështje ligjore që nuk ka lidhje me trafikimin, si divorci, kujdestaria, trashëgimia, pronësia pasurisë).

- ✓ Mentorim dhe mbështetje nga bashkëmoshatarët (aktivitete socializimi që, nëpërmjet krijimit të modeleve dhe të punuarit me bashkëmoshatarët, i lejojnë përfituesit të formësojë lidhje shoqërore të shëndetshme, të ndihen më pak të izoluar dhe të stigmatizuar, të krijojnë besimin, vetëvlerësimin, dhe të rrisin aftësitë për shmangien e shfrytëzimit ose të marrëdhënieve personale të dëmshme).
- ✓ Asistencë për pjesëtarët e familjes së përfituesit, mbështetjen e familjes për të ruajtur një nivel të kënaqshëm ekonomik (ndihmën ndaj prindërve për të gjetur punë ose për të ngritur një biznes, këshillim dhe mbështetje psikologjike për të gjithë familjen, kujdes shëndetësor për pjesëtarët e familjes, trajtime të specializuara që kontribuojnë në një mjedis familjar të shëndetshëm, si trajtimi i abuzimit me substanca).

Stafi i riintegritit monitoron përfituesit në vendndodhje të ndryshme: në shtëpi me familjet e tyre, kur jetojnë të pavarur, në shtëpi-familje dhe në familje kujdestare, e kështu me radhë. Stafi monitorin përfituesit gjatë fazës së riintegritit, të paktën një herë në muaj, qoftë nëpërmjet vizitave direkte apo telefonatave. Ndjekja sistematike afatgjatë është një pjesë e rëndësishme e punës së riintegritit, pasi e lejon stafin të identifikojë dhe adresojë nevojat e përfituesve që mund të dalin, si dhe të mbështesë përfituesit në kapërcimin e vështirësive të hasura gjatë procesit të riintegritit. Gjithashtu, është e rëndësishme për t'i pajisur përfituesit me informacion për të aksesuar shërbime dhe mbështetje brenda komunitetit ku ata jetojnë.

Stafi i riintegritit ofron gjithashtu asistencë psikosociale të rregullt për përfituesit në këtë periudhë. Monitorimi afatgjatë kryhet përtej periudhës së ndërhyrjes, deri në pesë vjet pas ndërhyrjes fillestare të krizës dhe përtej periudhës së asistencës dhe mbështetjes. Përfituesit monitorohen dhe ndiqen rregullisht për të siguruar se nuk do të përballen me kriza ose pengesa, dhe për të siguruar se procesi i riintegritit të tyre po shkon mirë.

**“Mbështetja që kam marrë më ndihmoi shumë për të menduar dhe vendosur për të ardhmen time. Jam praktikuar shumë në rrobaqepësi, dhe tani kam një punë dhe e ndaj apartamentin me vajza të tjera. Tani jam e qartë për të ardhmen dhe di se çfarë të bëj dhe se si të arrij qëllimet e mia. Ndihem e lirë dhe e gatshme për të përballuar gjithçka. (E re, e trafikuar për shfrytëzim seksual, e asistuar nga D&E).**

Përveç kësaj, është e rëndësishme të punohet me komunitetet për të krijuar një mjedis të shëndetshëm për kthimin e viktimave të trafikimit – për të rritur njohuritë e komunitetit për trafikimin dhe për të inkurajuar anëtarët e komunitetit që të pranojnë, mbështesin dhe të mos diskriminojnë viktimat e trafikimit.

### Asistenca në fazën e riintegritit dhe përfshirjes

“Klea” u trafikua pesë vjet më parë për shfrytëzim seksual. Ajo është asistuar për një periudhë mbi tre vite, gjatë së cilës iu ofruan forma të ndryshme të asistencës për të mbështetur rikuperimin dhe riintegrimin e saj. Tani po ia del mbanë dhe po jeton e pavarur. Ajo ka një punë të qëndrueshme dhe punon si dizenjuese grafike në një biznes privat në qytet dhe është në gjendje që me pagën e saj të mbështesë veten. Ajo ka marrëdhënie të mirë me prindërit, edhe pse ka vendosur të jetojë vetëm në kryeqytet. Ajo i viziton herë pas here dhe kalon fundjavat me ta. Ajo ka pak shoqe, që kryesisht i ka bërë pasi u largua nga strehëza, me të cilët ndihet shumë mirë. Ajo qëndron në kontakt me stafin nga organizata që ofron asistencë dhe herë pas here kërkon informacion rreth shërbimeve të ofruara nga bashkia dhe institucionet shtetërore.

Mbështetja dhe monitorimi gjatë kësaj faze kryhet nga menaxheri i rastit, i cili mund të ketë akses nga mbështetja e të tjerëve, si anëtarët e EMD-së ose ofruesit e shërbimit në komunitetin ku banon viktimja.

Menaxherët e rastit janë në dispozicion për t'i dhënë përgjigje pyetjeve dhe për të ofruar edhe informacion rreth mbështetjes dhe shërbimeve të tjera të disponueshme për ta në komunitetin e tyre. Mund të përfshihen edhe profesionistë të tjerë për të mbështetur përpjekjet për riintegrim, veçanërisht ato në komunitetin lokal dhe shpesh jo të specializuar në shërbimet kundër trafikimit. Këtu përfshihen:



**Stafi arsimor** (për shembull, mësues shkolle, psikologë shkolle, drejtorë dhe administratorë shkolle) për të mbështetur rifutjen në shkollë, aksesuar programe arsimore alternative, ofruar materiale shkollore, aksesuar ndihmë në përgatitjen e mësimave dhe mbështetje pas shkolle.



**Stafi mjekësor** (për shembull, mjek familjeje, administratorë mjekësorë, mjekë të specializuar, si pediatër dhe psikiatër) për të aksesuar shërbimet shëndetësore, duke përfshirë shërbime të specializuara, qendra komunitare të shëndetit mendor në rastin e problemeve të shëndetit mendor.



**Profesionistët e punësimit dhe fuqizimit ekonomik** (për shembull, stafi i zyrës së punës, administratorë, stafi i qendrave të formimit profesional) për të aksesuar formimin profesional, mundësitë për punësim dhe programet e punësimit.



**Administratorët publikë** (për shembull, në bashki, agjenci ose zyra të ndryshme shtetërore) për të aksesuar dokumentet e identifikimit dhe shërbimet shtetërore, si programet e skemave të strehimit, kujdesi për fëmijët, shërbimet shëndetësore dhe ndihma ekonomike.



**Punonjësi social** (për shembull, punonjësit socialë shtetërorë, asistentë socialë) për të aksesuar shërbimet dhe përfitimet sociale, si dhe të drejtat dhe përfitimet e viktimës së trafikimit.



**Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve**, për t'u ofruar fëmijëve shërbime sociale dhe për të ndjekur dhe monitoruar progresin e tyre.

Faza e riintegrit dhe përfshirjes karakterizohet nga disa arritje kryesore. Megjithatë kjo ndryshon nga njëri person te tjetri, disa etapa të zakonshme përfshijnë:



Zgjidhjen e strehimit afatgjatë



Punësimin afatgjatë; ruajtjen e punësimit të qëndrueshëm me kalimin e kohës



Aftësi të përmirësuara për jetën që përdoren me sukses në jetën e përditshme.



Marrëdhënien e qëndrueshme dhe të përmirësuara me familjen



Stabilizim emocional dhe mirëqenie sociale



Aftësinë për të plotësuar nevojat e veta dhe për të përballuar problemet



Pjesëmarrjen në jetën dhe ndërveprimet sociale



Përjetimin e një standardi të arsyeshëm jetese

Nëpërmjet ndjekjes, menaxherët e rastit vlerësojnë ndikimin afatgjatë të asistencës së ofruar lidhur me rezultate të ndryshme të riintegrit, të përmendura më sipër. Kur një viktimë vlerësohet e riintegruar me sukses, dosja e saj mund të mbyllet. Mbyllja e rastit është më efektive kur ndodh si pjesë e një procesi të dakordësuar dhe planifikuar në mënyrë reciproke, kur janë arritur qëllimet e planit të rastit. Kur progresi është monitoruar dhe rishikuar rregullisht, ka gjasa që vendimi për mbyllje të jetë reciprok.

### Çështje dhe konsiderata të veçanta në ndihmën e fëmijëve të trafikuar në fazën e riintegrit dhe përfshirjes

- **Kohëzgjatjen e procesit të riintegrit:** Procesi i riintegrit të fëmijëve ka tendencën të jetë më i gjatë se te të rriturit. Kjo ndodh për shkak se ndikimi i trafikimit të fëmijët është shpesh më i madh se te të rriturit, siç shpjegohet më poshtë, dhe ata kërkojnë më shumë kohë për t'u rikuperuar. Gjithashtu, ndodh për shkak se shërbimet që ata kanë nevojë, si arsimi formal, kanë kohëzgjatje më të madhe. Krahas mbështetjes arsimore, ata kanë zakonisht nevojë për formim profesional për t'u përgatitur për të ardhmen dhe mundësitë për punësim.
- **Ndikimin e trafikimit të fëmijët:** Fëmijët kanë aftësi më pak të zhvilluara të përballimit sesa të rriturit, dhe rrjedhimisht ndikimi i trafikimit të fëmijët ka gjasë të jetë më i madh. Fëmijët e trafikuar janë të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të abuzimit dhe traumës, dhe kërkojnë trajtim dhe monitorim për një periudhë më të gjatë. Mënyra, kohëzgjatja dhe intensiteti i trafikimit tregojnë se sa ndikohet një fëmijë. Sa më e gjatë koha e trafikimit të fëmijës, aq më e gjatë koha e rikuperimit dhe rrjedhimisht më e madhe vigjilenca e këtyre fëmijëve. Sa më gjatë të trafikohet një fëmijë, aq më e gjatë është koha e riintegrit dhe rrjedhimisht aq më shumë vëmendje dhe mbështetje nevojitet.
- **Gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme:** Kur fëmijët nuk janë në gjendje të kthehen në familjen e tyre, kjo e ndërlikon më tej riintegrimin dhe përfshirjen pasi ka mundësi të kufizuara për kujdes afatgjatë dhe strehim rezidencial nuk është i përshtatshëm për riintegrimin afatgjatë të fëmijëve. Nëse fëmijët nuk jetojnë së bashku me familjen, nevojiten mundësi të tjera akomodimi.
- **Përfshirjen në aktivitete komunitare të rinjve:** Është e rëndësishme që fëmijët të angazhohen në mënyrë aktive në jetën e tyre të përditshme. Përfshirja në aktivitete komunitare mund të nxisë vetëbesimin dhe vetëvlerësimin e tyre, dhe t'i ndihmojë ata të zhvillojnë aftësi sociale dhe ndërpersonale, si dhe të rritin ose forcojnë rrjetin e tyre social.

### Konsiderata të veçanta për fëmijët viktime të trafikimit në fazën e riintegrit dhe përfshirjes

“Meri” bën 18 vjeç për pak muaj. Ajo hyri në programin e riintegrit kur ishte 14 vjeç, pasi ishte trafikuar brenda vendit për shfrytëzim seksual dhe shpërndarje droge. Gjatë këtyre viteve, ajo u përball me shumë sfida, duke përfshirë kapërcimin e pasojave shumë serioze të trafikimit për shfrytëzim seksual në një moshë kaq të re. Ajo kishte edhe probleme me familjarët e saj, të cilët nuk e pranonin dhe e fajësonin për trafikimin. Meri ka marrë mjaft asistencë për të trajtuar

problemet me familjen e saj, dhe me kalimin e kohës ia ka dalë të formësojë një marrëdhënie të qëndrueshme me nënën dhe me një nga vëllezërit, edhe pse vazhdon të ketë probleme me njërin vëlla. Për shkak të këtyre traumave të rënda në fëmijëri, ajo ka luftuar për të menaxhuar emocionet e saj dhe ndonjëherë bëhej agresive. Pas disa vitesh mbështetje ajo ka mësuar të njohë reagimet e saj dhe të kërkojë ndihmë kur ka nevojë të menaxhojë ndjenjat e saj. Është një e re e fortë, me shumë talente. Aktualisht, ajo po diplomohet në shkollë e muzikës, një shkollë e mesme profesionale, dhe shpreson të studiojë në Akademinë e Arteve në Universitet. Megjithatë, edhe pas kaq shumë vitesh, ajo ka ende nevojë për mbështetje për të realizuar planet dhe ëndrrat e saj për të pasur një karrierë si këngëtare dhe muzikante.

## Çështjet kryesore në fazën e riintegritit dhe përfshirjes Udhëzime për profesionistët

Udhëzimet e mëposhtme jepen për të mbështetur profesionistët e riintegritit në këtë periudhë të riintegritit dhe përfshirjes.

- Kuptoni se riintegrimi dhe përfshirja do të përfshijë suksese të rëndësishme për t'u festuar, po gjithashtu mund të ketë disa dështime dhe pengesa dhe viktimat do të kenë nevojë për mbështetje.**
- Nxiteni përfituesin të vazhdojë të bëjë hapa përpara me planin e riintegritit të tyre.** Shqyrtoni dhe rishikoni planin e riintegritit kur nevojitet dhe si përgjigje ndaj ngjarjeve jetësore, duke siguruar që të jetë realist dhe i arritshëm. Mbështetini që t'iu besojnë instinkteve dhe aftësive të veta që kanë mësuar. Lërimi të kuptojnë se jeta është plot surpriza dhe se gjërat nuk do të funksionojnë gjithmonë siç janë planifikuar, por ata kanë aftësi për t'u ambientuar dhe përshtatur.
- Sigurohuni që përfituesi të përfshihet dhe të jetë në qendër të të gjitha vendimeve për riintegritin e tyre.** Kjo përfshin fëmijët të cilët duhet të mbahen të informuar dhe angazhuar në vendimmarrje mbi atë çfarë plotëson më mirë nevojat dhe interesat e tyre.
- Kryeni monitorim dhe ndjekje të vazhdueshme të rregullt gjatë kohëzgjatjes së riintegritit.** Jini të disponueshëm dhe të përgjigjshëm ndaj nevojave të përfituesve. Sigurohuni që përfituesi të angazhohet në monitorim të vazhdueshëm.
- Të jeni të përgatitur për çdo problem të mundshëm të sigurisë që mund të shkaktohen gjatë monitorimit dhe hartoni një plan që i shmang këto rreziqe (për shembull, intervistimi i përfituesve në komunitetet e tyre, diskutimi me pjesëtarët e familjes).** Shmangni çdo aktivitet monitorues që mund të shkaktojë lëndim. Konsultohuni me viktimat për të siguruar një vlerësim të saktë dhe realist të çështjeve të sigurisë dhe të qenit i sigurt.
- Jini mbështetës dhe të duruar në të gjitha ndërveprimet me përfituesin.**
- Ofroni këshilla dhe mbështetje kur është e nevojshme, por gjithashtu mbështeteni përfituesin të japë zgjidhjet e veta për problemet që mund të lindin.** Nxitini që t'i gjejnë këto zgjidhje.

**Përqendrohuni në pikat e forta dhe aftësia ripërtëritëse e përfituesve, dhe nxitini që të kenë akses tek ato.** Kujtojeni se ia dolën mbanë ta përballonin të gjithë këtë proces, dhe se si mund t'i përballojnë sfidat e tjera që mund të hasin.

**Mbani linja të hapura komunikimi me përfituesin në çdo kohë, në mënyrë që ata të ndihen rehat t'ju kontaktojnë në çdo moment dhe të bëjnë pyetje në lidhje me nevojat e tyre dhe si mund të përmbushen ato.**

**Jepuni përfituesve mundësi për të marrë pjesë dhe për t'u angazhuar në grupet mbështetëse të bashkëmoshatarë ose me bashkëmoshatarët, apo alternativa të tjera për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre social.**

**Sigurohuni që qasja juaj në punën me viktimat të jetë me në qendër viktimën, me ndjeshmëri ndaj gjinisë, miqësore me fëmijën, e përshtatshme në aspektin kulturor dhe e informuar rreth traumave.** Kërkoni udhëzime dhe mbështetje nga supervizoret dhe kolegët për t'u siguruar se kjo është mënyra e duhur. Jini të hapur ndaj sugjerimeve se si mund të zbatohen këto qasje në praktikë.

**Kërkoni dhe pranoni mbështetje dhe udhëzime kur janë të nevojshme.** Komunikoni dhe punoni me supervizorin tuaj për çdo problem dhe shqetësim që hasni. Kërkoni këshilla, udhëzime dhe mbështetje edhe nga kolegët tuaj.

**Kini parasysh se puna me fëmijët e trafikuar në fazën e riintegritit dhe përfshirjes ka sfida dhe pengesa specifike që mund t'ju duhet t'i zgjidhni.** Në këtë fazë, punoni ngushtë me punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, si dhe me profesionistë të tjerë në komunitetin ku viktimat riintegrohet.

**Sigurohuni që të gjitha vendimet në rastin e një fëmije të trafikuar të jenë në interesin më të lartë të fëmijës.** Përfshijeni fëmijën në këtë vlerësim të alternativave dhe veprimeve të ndërmarra, dhe diskutoni paraprakisht çdo vendim me fëmijën. Sigurohuni që të gjitha masat të merren me pëlqimin e prindit (ose kujdestarit ligjor), dhe e mira do të ishte edhe me pëlqimin e fëmijës.

**Kushtojini vëmendje dhe konsideratë të veçantë përfituesve, rasteve më komplekse apo të vështira.** Megjithëse varion, këtu mund të përfshihen fëmijët e trafikuar (veçanërisht ata pa kujdes prindëror); viktimat pa mbështetje familjare; viktimat e trafikimit me persona në varësi, veçanërisht fëmijë; viktimat që janë të marginalizuara; ato me probleme të shëndetit mendor; viktimat me aftësi të kufizuara; viktimat që nuk janë marrë në konsideratë (si burrat dhe djemtë); viktimat me probleme të abuzimit me substanca; viktimat me gjendje shëndetësore të rëndë ose kronike; ato pa dokumente ose status ligjor; viktimat me probleme të sigurisë.

## **Shtojcat**

**Shtojca #1. Fjalorthi i termave**

**Shtojca #2. Arritjet kryesore në faza të ndryshme të riintegrit**

**Shtojca #3. Ndjenjat dhe sjelljet e viktimave në faza të ndryshme të riintegrit**

**Shtojca #4: Parimet etike dhe udhëzimet në punën me viktimat e trafikimit**

**Shtojca #5: Studime dhe burime mbi riintegrimin nga D&E dhe Instituti NEXUS**



## Shtojca #1. Fjalorthi i termave




<b>Termi</b>	<b>Përkufizimi</b>
<b>Asistencë</b>	Masa vullnetare, programe dhe shërbime që synojnë rikuperimin e personave të trafikuar, të ofruara nga shteti, organizata jofitimprurëse (OJF), dhe organizata ndërkombëtare (IOs), në vendet e destinacionit, tranzitit dhe origjinës. Asistenca mund të jetë specifike për trafikimin ose në forma më të përgjithshme të asistencës, të ofruar si pjesë e shërbimeve shtetërore të përgjithshme, si sistemet e mbrojtjes së fëmijës ose shërbimet për personat e cenueshëm në aspektin social. Asistenca mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në: akomodimin/strehimin, kujdesin mjekësor, asistencën psikologjike, arsimin, formimin profesional, aftësitë jetësore, punësimin dhe fuqizimin ekonomik, asistencën ligjore, transportin, dhe ndërmjetësimin/këshillimin familjar.
<b>Qasje miqësore me fëmijën</b>	Hartimi dhe zbatimi i masave duke pasur parasysh nevojat, interesat, sigurinë dhe interesat më të larta të fëmijës
<b>Qasje e përshtatshme në aspektin kulturor</b>	Marrja në konsideratë dhe respektimi i besimeve kulturore dhe fetare, vlerat, normat, praktikat dhe gjuhën e viktimës
<b>Qasje me ndjeshmëri gjinore</b>	Trajtimi i të gjitha viktimave me të njëjtin respekt, pavarësisht identitetit të tyre gjinor, duke shmangur stereotipet ose supozimet mbi baza gjinore
<b>Identifikim</b>	Identifikimi është procesi në të cilin individi identifikohet si viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme e trafikimit. Identifikimi formal është procesi ose vendimi që rezulton në një vendim shtetëror zyrtar se një person është viktimë e trafikimit, ndërsa identifikimi joformal është procesi ose vendimi që rezulton në faktin që një person konsiderohet viktimë e trafikimit jashtë procesit të identifikimit formal të shtetit.
<b>Viktimë e prezumuar (ose e mundshme) e trafikimit</b>	Personi që është konsideruar dhe identifikuar si viktimë e trafikimit, por që formalisht nuk është identifikuar si e tillë.
<b>Mbrojtje</b>	Një nga tre P-të (Protection) të përgjigjes kundër trafikimit, synon mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Në përgjithësi, përfshin procesin e identifikimit, referimit, dhe asistencë, duke përfshirë riintegrimin.  Gjithashtu, i referohet rolit të çdo qeverie për të ndërmarrë hapa afirmativë për të vlerësuar rreziqet dhe për të garantuar sigurinë e çdo viktime.

<b>Riintegrim</b>	Procesi i rikuperimit dhe përfshirjes ekonomike dhe sociale pas një përvoje trafikimi. Ai përfshin: sistemimin në një mjedis të sigurt dhe të siguruar; aksesin në një jetese standarde të arsyeshme; mirëqenien mendore dhe fizike; mundësitë për zhvillim personal, social dhe ekonomik; dhe aksesin në mbështetje sociale dhe emocionale. Riintegrimi mund të përfshijë kthimin në familjen dhe/ose komunitetin e origjinës së viktimës, integrimin në një komunitet të ri, ose integrimin në një shtet të ri në varësi të nevojave dhe interesave specifike të individit. Riintegrimi ndodh në nivele të ndryshme: në nivel individual, në mjedisin familjar, në komunitetin e gjerë dhe në shoqërinë formale. <sup>18</sup>
<b>Qasja e informuar mbi traumen</b>	Njohja e ndikimit të traumës dhe promovimi i mjediseve të shërimit dhe rikuperimit
<b>Qasja me në qendër viktimën</b>	Prioritizimi i dëshirave, sigurisë dhe mirëqenies së viktimës në të gjitha çështjet dhe procedurat
<b>Trafikim i personave (TiP)</b>	Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose marrja e personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit të pushtetit ose të një pozicioni të pambrojtur ose të dhënien ose marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi; shfrytëzimi do të përfshijë, të paktën, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjes së organeve. <sup>19</sup>
<b>Viktimë trafikimi (VT)</b>	Personi që ka përjetuar dhe/ose përjeton sjellje të përcaktuara sipas nenit 3 të <i>Protokollit të Kombeve të Bashkuara për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve (Protokolli i Trafikimit)</i> ose në legjislacionin përkatës vendas.




<sup>18</sup> R. Surtees (2008) *Ri/integrimi i personave të trafikuar: si mund të jetë puna jonë më efektive?* Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni King Baudouin, f. 11.

<sup>19</sup> Kombet e Bashkuara (2002) *Protokolli për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve*. Kombet e Bashkuara.

## Shtojca #2. Arritjet kryesore në faza të ndryshme të riintegrit

 <b>Faza e krizës</b>	 <b>Faza e tranzicionit</b>	 <b>Faza e riintegrit dhe përfshirjes</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pranimi i situatës së vet jetësore; gjetja e kuptimit dhe qëllimit në jetën e vet të re</li> <li>- Krijimi i një rutine dhe ritmi të ri të jetës</li> <li>- Reduktimi i traumës dhe vështirësive emocionale; sukcesi në kapërcimin e përvojës së trafikimit</li> <li>- Përmirësimi i mirëqenies fizike dhe psikologjike, duke përfshirë vetëbesimin dhe autonominë personale</li> <li>- Mundësia për të menaxhuar mjedisin e vet të ngushtë</li> <li>- Aftësia për të shfaqur empati, afeksion dhe afrimitet</li> <li>- Përmirësimi i marrëdhënieve familjare dhe shoqërore në përgjithësi</li> <li>- Mundësia për të qenë të mbrojtur dhe të sigurtë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pajisja me informacion mbi mbështetjen dhe shërbimet e disponueshme në komunitet (shërbime specifike për viktimat e trafikimit dhe shërbime sociale në përgjithësi, nga institucione shtetërore dhe OJF-të)</li> <li>- Rritja e aftësive për jetën (duke përfshirë krijimin e marrëdhënieve të shëndetshme, aftësitë e komunikimit, aftësitë e prindërimit, menaxhimin e kohës dhe parave, gatimin, pastrimin)</li> <li>- Gjetja e strehimit të qëndrueshëm</li> <li>- Përfundimi i formimit profesional që lidhet me mundësitë dhe aspiratat për punë</li> <li>- Gjetja dhe mbajtja e punës dhe krijimi i marrëdhënieve konstruktive në punë dhe të sjelljeve profesionale</li> <li>- Frekuentimi i shkollës dhe diplomimi</li> <li>- Rritja e ndjenjës së autonomisë</li> <li>- Motivimi dhe angazhimi në procesin e riintegrit</li> <li>- Rritja personale, duke përfshirë rritjen dhe qëndrueshmërinë emocionale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zgjidhja e strehimit afatgjatë</li> <li>- Punësimi afatgjatë; mbajtja e punës në vazhdimësi</li> <li>- Aftësi jetësore të përmirësuara që përdoren me sukses në jetën e përditshme</li> <li>- Marrëdhënie të qëndrueshme dhe të përmirësuara me familjen</li> <li>- Qëndrueshmëri dhe mirëqenie sociale</li> <li>- Aftësi për të plotësuar nevojat e veta dhe për të përballuar problemet</li> <li>- Pjesëmarrje në jetën shoqërore dhe ndërveprimet sociale</li> <li>- Përjetimi i një standardi të arsyeshëm jetese</li> </ul>

### Shtojca #3. Ndjenjat dhe sjelljet e viktimave në faza të ndryshme të riintegrit

 <b>Faza e krizës</b>	 <b>Faza e tranzicionit</b>	 <b>Faza e riintegrit dhe përfshirjes</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zemerim, agresivitet dhe frustrim, duke përfshirë shpërthime, sjellje impulsive, agresivitet ndaj të tjerëve dhe vetes (lëndimi i vetes dhe tentativa për vetëvrasje)</li> <li>- Rikthime në kujtesë dhe makthe për ngjarje traumatike</li> <li>- Ankth, frikë, nervozizëm, duke përfshirë vështirësinë për t'u përqendruar</li> <li>- Dyshim dhe mosbesim ndaj të tjerëve</li> <li>- Reagime fizike (rrahje te larta të zemrës, tension muskolor, sulme ankthi)</li> <li>- Mohim (duke mohuar që trafikimi ka ndodhur ose ngjarje të këqija gjatë trafikimit)</li> <li>- Ndjenja kontradiktore (të dashurisë dhe urrejtjes ndaj trafikantëve dhe abuzuesve, veçanërisht kur trafikohen nga partneri ose bashkëshorti)</li> <li>- Pesimizëm dhe shpresë të kufizuar për të pasur një "jetë normale" (për t'u martuar, për të pasur një familje, për të pasur karrierë)</li> <li>- Ndjenjë çlirimi (për ndryshimin e pritur në jetë)</li> <li>- Probleme ose çrregullime të gjumit (pagjumësi, apnea e gjumit, parasomnia (çrregullime të gjumit), makthe</li> <li>- Gjendje emocionale e lartë ose e ulët</li> <li>- Ndjesia e të qenit të pashpresë, duke përfshirë motivimin e ulët për rikuperim dhe riintegrim, dhe humbjen e interesit në aktivitetet e përditshme dhe në jetë në përgjithësi</li> <li>- Ndjenja të fajit dhe turpit (për shkak se janë trafikuar, kanë dështuar në migracion, aktet e kryera ndërkohë që janë trafikuar)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gëzim dhe shpresë (ndjekja e ëndrrave, qëllimeve)</li> <li>- Frikë nga ndryshimi (ndryshime në rutinë duke u përballur me situata të reja që mund të jenë të vështira për t'u menaxhuar)</li> <li>- Entuziazëm (për gjëra të reja që do të ndodhin, marrëdhënie dhe kontakte të reja)</li> <li>- Padurim për gjëra të reja</li> <li>- Vetëbesim dhe vetëvlerësim të shtuar falë aftësive të reja, kapaciteteve dhe përvojave jetësore</li> <li>- Konfuzion dhe shqetësim për të ardhmen, situatat e reja të jetës dhe procesi i riintegrit</li> <li>- Ekstremitet në reagimet emocionale (ndarja e informacionit personal, të folurit shumë për përvojën apo situatën e vet, mbajtjen private të gjithçkaje)</li> <li>- Frikë nga dështimi, mohimi i aftësive personale, mospërparimi në arritjen e qëllimeve</li> <li>- Padurim, shkuarja drejt sjelljes së pakujdesshme dhe të pamenduar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndjenja të mirëqenies (të jetuarit në mënyrë të pavarur dhe marrja vetë e vendimeve)</li> <li>- Kënaqësi në eksplorimin, zbulimin dhe të nxëniet e gjërave të reja</li> <li>- Kënaqësi e të qenurit në gjendje për përmbushjen e nevojave të veta</li> <li>- Të qenit në gjendje për të shfaqur empati ndaj të tjerëve në situata të ngjashme</li> <li>- Emocion (për fillimin e një jete të re, mbështetja te vetvetja)</li> <li>- Mirënjohje (për individët që i mbështesin në kohë të vështira)</li> <li>- Konfuzion, frustrim dhe dyshim mbi menaxhimin e të ardhmes dhe ndryshimeve që dalin</li> <li>- Vetëbesim në përmirësimin dhe përdorimin e aftësive të veta</li> <li>- Besim (të besuarit te vetja, te të tjerët, në shoqëri dhe strukturat shoqërore)</li> <li>- Krenari për suksesin e vet dhe të qenit në gjendje për të shërbyer si model për ata që janë në fazat e hershme të riintegrit</li> </ul>

## Shtojca #4: Parimet etike dhe udhëzimet në punën me viktimat e trafikimit

Udhëzimet e mëposhtme janë marrë nga manuali për menaxhimin e rasteve të viktimave të trafikimit i organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë”,<sup>20</sup> i hartuar për të orientuar punën e organizatave, të profesionistëve të saj dhe të agjencive dhe profesionistëve me të cilët punon. Ky udhëzues zbatohet për ofrimin e asistencës dhe mbështetjes në çdo fazë të rikuperimit dhe riintegritimit:

- ✓ Gjatë gjithë punës suaj përdorni një qasje të informuar mbi traumën.
- ✓ Viktima është qendra e të gjitha proceseve dhe diskutimeve.
- ✓ Pjesëmarrja e viktimave është shumë e rëndësishme.
- ✓ Kujdesi ndaj viktimës duhet të jetë i vazhdueshëm përmes një pike të vetme kontakti, pavarësisht se si ofrohet kujdesi ndaj tij/saj;
- ✓ Viktima ka të drejtën të marrë informacion të plotë, të saktë dhe të paanshëm në lidhje me mundësitë dhe rezultatet e mundshme të vendimeve të tij/saj. Viktima ka të drejtën të marrë vendime të informuara për të gjitha aspektet e kujdesit ndaj tij/ saj, përfshirë të drejtën për të refuzuar kujdesin dhe për të refuzuar referimin për konsultim të specializuar, ose transferimin e përgjegjësisë për menaxhimin e rastit.
- ✓ Komunikimi mes palëve në lidhje me viktimën, do të përfshijë viktimën dhe duhet të jetë i hapur, i qartë, në kohën e duhur dhe i dokumentuar siç duhet.
- ✓ Referimi për ndihmë të specializuar do të trajtohet si një e drejtë e viktimës. Do të bëhen të gjitha përpjekjet për të identifikuar burimet e ndihmës së specializuar të përballueshme, me anë të procedurave jodiskriminuese.
- ✓ Qasja e referimit do të jetë e qëndrueshme në të gjitha hapat, me përjashtim të disa rasteve dhe kushteve të veçanta.
- ✓ Viktimat nuk duhet të referohen asnjëherë te ofrues të shërbimeve që janë të paautorizuar dhe që praktikojnë, ushtrojnë veprimtari përtej mundësive dhe sferës së veprimit të tyre;
- ✓ Viktima nuk do të referohet për ato nevoja që organizata përgjegjëse për menaxhimin e rastit ka për detyrë t'i përmbushë.
- ✓ Stafit nuk duhet të veprojnë asnjëherë përtej kompetencave të tij për të shmangur referimin e nevojshëm.
- ✓ Profesionistët e përfshirë në referim janë përgjegjës për dokumentimin e duhur të vendimeve të tyre, duke përfshirë çdo variacion nga ky manual, si dhe rrethanat e çdo ndryshimi të tillë.
- ✓ Referimi duhet të mbështetet te kompetencat e bazuara në aftësi dhe jo në besimet dhe vlerat e stafit.
- ✓ Viktimat nuk duhet të detyrohen kurrë që të pranojnë shërbimet tek të cilat ato eferohen.
- ✓ Duhet të shmangen referimet që ndërpresin trajtimin e viktimës dhe për këtë arsye janë të dëmshme.

---

<sup>20</sup> Të Ndryshëm & Të Barabartë (2020) *Manuali i menaxhimit të rastit për viktimat e trafikimit në Shqipëri*. Tiranë, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. Për udhëzime të mëtejshme etike mbi punën për riintegrimin e viktimave të trafikimit, ju lutemi shihni: Surtees, R. (2013) *Parimet etike në riintegrimin e personave të trafikuar*. Uashington, D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni i Mbretit Baudouin.

## Shtojca #5: Studime dhe burime mbi riintegrimin nga D&E dhe Instituti NEXUS

Brunovskis, A. & R. Surtees (2012) *A fuller picture. Addressing assistance needs and vulnerabilities*. Oslo: Fafo& Washington: NEXUS Institute. Available at: [https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/no-place-like-home\\_familyreintegration\\_nexus.pdf](https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/no-place-like-home_familyreintegration_nexus.pdf)

Brunovskis, A. & R. Surtees (2012) 'Coming home. Challenges in family reintegration', *Qualitative Social Work*. Available at: <https://journals.sagepub.com/doi/pdf/10.1177/1473325011435257>

Brunovskis, A. & R. Surtees (2012) *No place like home? Challenges in family reintegration*. Oslo: Fafo & Washington, D.C.: NEXUS Institute. Available at: [https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/no-place-like-home\\_familyreintegration\\_nexus.pdf](https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/no-place-like-home_familyreintegration_nexus.pdf)

Brunovskis, A. & R. Surtees (2008) 'Agency or illness. The conceptualization of trafficking victims' choices and behaviours in the assistance system', *Gender technology and development*. Available at: <https://www.tandfonline.com/doi/pdf/10.1177/097185240701200105?needAccess=true>

Brunovskis, A. & R. Surtees (2007) *Leaving the past behind. When trafficking victims decline assistance*. Oslo: Fafo & Washington, D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexusinstitute.net/publications/assistance-and-reintegration-of-trafficking-victims/>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2021) *Mbrojtja e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi; Udhëzues për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë.

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2020) *Manual për menaxhimin e rasteve të viktimave të trafikimit në Shqipëri*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në: [http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2021/07/CASE-MANAGEMENT-MANUAL-DE\\_compressed.pdf](http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2021/07/CASE-MANAGEMENT-MANUAL-DE_compressed.pdf)

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2019) *Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në: [http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2020/05/E-fundit-Shtepia-e-gjyshes-ose-shtepia-tjeter\\_libri\\_shqip\\_Ok.pdf](http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2020/05/E-fundit-Shtepia-e-gjyshes-ose-shtepia-tjeter_libri_shqip_Ok.pdf)

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2019) *Studim mbi nevojat dhe mundësitë që ofron tregu i punës për të mbështetur fuqizimin ekonomik të të mbijetuarave të trafikimit dhe dhunës në familje në Tiranë, Kukës, Dibër dhe Sarandë*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në: <http://differentandequal.org/sq/studimi-mbi-tregun-e-punes/>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2019) *Standardet e Shërbimit të Njësive Lëvizëse për Identifikimin dhe Referimin e viktimave /viktimave të mundshme të trafikimit*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në: <http://differentandequal.org/sq/standardet-e-sherbimit-te-njesive-levizese-per-identifikimin-dhe-referimin-e-viktimave-viktimave-te-mundshme-te-trafikimit/>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2015) *Të lënë pas dore! Trafikimi i burrave dhe djemve në Shqipëri*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në: <http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2018/12/Te-lene-pas-dore-1.pdf>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2009) *Studimi mbi Riintegrimin Social-Ekonomik të Viktimave të Trafikimit në Shqipëri*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në: <http://differentandequal.org/sq/studimi-mbi-riintegrimin-social-ekonomik-te-viktimave-te-trafikimit-ne-shqiperi/>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2009) Raporti Vjetor i organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë”. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në: <http://differentandequal.org/en/raporti-vjetor-2009/>

Surtees, R. (2019) ‘Feeling a failure: Returning home a ‘Trafficked man’ in Indonesia’, *openDemocracy*. Available at: <https://www.opendemocracy.net/en/beyond-trafficking-and-slavery/feeling-a-failure-returning-home-a-trafficked-man-in-indonesia/>

Surtees, R. (2018) ‘At home. Family reintegration of trafficked Indonesian males’, *Antitrafficking review*. No. 10. Available at: [www.antitraffickingreview.org/index.php/atrjournal/article/view/322](http://www.antitraffickingreview.org/index.php/atrjournal/article/view/322)

Surtees, R. (2017) ‘Being Home. Exploring Family Reintegration Among Trafficked Indonesian Domestic Workers’. In R. Piotrowicz, C. Rijken and B. Heide Uhl (Eds.) *Routledge Handbook on Human Trafficking*. Routledge. Available at: <https://www.routledge.com/RoutledgeHandbook-of-Human-Trafficking/Piotrowicz-Rijken-Uhl/p/book/9781138892064>

Surtees, R. (2017) *Moving on. Family & community reintegration among Indonesian trafficking victims*. Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2020/02/moving-on-nexus-institute-2017.pdf>

Surtees, R. (2017) *Our Lives. Vulnerability & resilience among Indonesian trafficking victims*. Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2020/02/our-lives-nexus-institute-2017.pdf>

Surtees, R. (2017) *Supporting the reintegration of trafficked persons. A Guidebook for the Greater Mekong Sub-Region*. Bangkok, Thailand: NEXUS Institute, UN-ACT and World Vision. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2017/04/final-reintegration-guidebook-gms.pdf>

Surtees, R. (2017) ‘Declining assistance. Understanding trafficked persons’ decisions, choices and resiliency’. In A. Aronwitz (Ed) *Human trafficking: A Reference Handbook*. ABC-CLIO. Available at: <https://www.amazon.com/Human-Trafficking-Reference-HandbookContemporary-ebook/dp/B01N9XAFJH>

Surtees, R. (2016) ‘What’s home? (Re)integrating children born of trafficking’, *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2): 73-100. Available at: <https://www.tandfonline.com/eprint/Z5HzV2AZAZnqmxCyiBi4/full>

Surtees, R. (2015) *Beyond trafficking. The re/integration of trafficking victims in the Balkans, 2007 to 2014*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/06/beyond-trafficking-final-report.pdf>

Surtees, R. (2014) *Reintegration of trafficked persons. Trafficked children & youth*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: [https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/pub\\_3268\\_reintegrationoftraffickedchildren.pdf](https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/pub_3268_reintegrationoftraffickedchildren.pdf)

Surtees, R. (2013) *Ethical principles in the reintegration of trafficked persons*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/02/ethical-principles-for-the-reintegrationof-trafficked-persons.pdf>

Surtees, R. (2013) *After trafficking. Experiences and challenges in the (re)integration of trafficked persons in the GMS*. Bangkok and Washington: UNIAP& NEXUS Institute. Available at: [https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/aftertrafficking\\_experiences-and-challenges-in-reintegration-in-the-gms.pdf](https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/aftertrafficking_experiences-and-challenges-in-reintegration-in-the-gms.pdf)

Surtees, R. (2012) *Reintegration of trafficked persons. Economic empowerment*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: [https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/nexus\\_economic-empowerment.pdf](https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/nexus_economic-empowerment.pdf)

Surtees, R. (2010) *Monitoring anti-trafficking re/integration programmes. A manual*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: [https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/monitoring-at-reintegrationprogrammes\\_manual\\_nexus.pdf](https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/monitoring-at-reintegrationprogrammes_manual_nexus.pdf)

Surtees, R. (2008) *Reintegration of trafficked persons. Handling “difficult” cases*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/reintegration-of-trafficked-personshandling-difficult-cases.pdf>

Surtees, R. (2008) *Reintegration of trafficked persons. How to be more effective*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/reintegration-of-trafficked-persons-howcan-our-work-be-more-effective.pdf>

Surtees, R. (2008) ‘Trafficked men and unwilling victims’, *St. Antony’s International Review*, 4(1), pp. 16-36. Available at: <https://www.ingentaconnect.com/content/stair/stair/2008/00000004/00000001/art00003>

Surtees, R. (2017) *Listening to victims: Experiences of identification, return and assistance in SE Europe*. Vienna: ICMPD & NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/listening-to-victims.pdf>

Surtees, R. & L.S. Johnson (2021) *Trafficking Victim Identification: A Practitioner Guide*. Washington D.C.: NEXUS Institute & Bangkok: Regional Support Office of the Bali Process. Available at: <https://nexusinstitute.net/past-projects/practitionerguideseries/>

Surtees, R. & L.S. Johnson (2021) *Trafficking Victim Protection and Support: A Practitioner Guide*. Washington D.C.: NEXUS Institute & Bangkok: Regional Support Office of the Bali Process. Available at: <https://nexusinstitute.net/past-projects/practitionerguideseries/>

Surtees, R. & L.S. Johnson (2021) *Recovery and Reintegration of Trafficking Victims: A Practitioner Guide*. Washington D.C.: NEXUS Institute & Bangkok: Regional Support Office of the Bali Process. Available at: <https://nexusinstitute.net/past-projects/practitionerguideseries/>

Surtees, R. & L.S. Johnson (2021) *Special and Additional Measures for Child Trafficking Victims: A Practitioner Guide*. Washington D.C.: NEXUS Institute & Bangkok: Regional Support Office of the Bali Process. Available at: <https://nexusinstitute.net/past-projects/practitionerguideseries/>



Surtees, R. & F. de Kerchove (2014) 'Who funds reintegration? Sustainable services for VoTs', *AntiTrafficking Review*. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/whofunds-reintegration.pdf>

Surtees, R., Johnson, L.S., Zulfahary, T & S. DaengCaya (2016) *Going home. Challenges in the reintegration of trafficked persons in Indonesia*. Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2017/09/going-home-english-final.pdf>

Surtees, R. & S. Somach (2008) *Methods and models of mixing services for victims of domestic violence and trafficking in persons*. Washington D.C.: USAID, Creative Associates International, Inc., and the Aguirre Division of JBS International, Inc. and the NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2019/01/methods-and-modelsfor-mixing-services-for-victims-of-domestic-violence-and-trafficking-in-persons.pdf>